

# Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal Komuna e Prizrenit

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



Implementuar nga:  
**UNOHABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:  
**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



---

# Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal Komuna e Prizrenit

Dhjetor 2012

---

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË



KOMUNA E  
PRIZRENIT

Implementuar nga:  
**UN HABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:  
**SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION**



## SHËNIM

Ky raport VSM (Raport) është përgatitur në mënyrë të pavarur nga konsulenti privat Kadri Tillemann me kërkesë të UN-Habitat-it duke e respektuar afatin dhe kushtet e kontratës përkatëse individuale. Këndvështrimet e shprehura në këtë Raport nuk janë domosdoshmërisht këndvështrime të UN-Habitat-it ose të komunës së Prizrenit. Konsulenti privat nuk merr përgjegjësi për vendimet dhe masat e marra në bazë të propozimeve dhe të përmbajtjes së këtij raporti.

### **Informatat kontaktuese:**

UN-Habitat Zyra në Prishtinë  
Ndërtesa e ministrive “Rilindja” kati i dhjetë  
1000 Prishtinë Kosovë  
Numri i telefonit: + 381 38 20032611  
E-mail: [info@unhabitat-kosovo.org](mailto:info@unhabitat-kosovo.org)

Komuna e Prizrenit  
Numri i telefonit + 381 029 242 406  
Numri i telefonit + 381 029 244 040  
E-mail: [info@prizreni-gov.org](mailto:info@prizreni-gov.org)

Kadri Tillemann  
Konsulent privat  
Numri i telefonit + 372 50 15 440  
E-mail: [kadri.tillemann@vesterra.ee](mailto:kadri.tillemann@vesterra.ee)

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>4</b>
<b>II.</b>	<b>HISTORIKU</b> .....	<b>6</b>
2.1	HYRJE .....	6
2.2.2	DIREKTIVAT E TJERA TË BE-SË .....	7
2.2.3	STRATEGJIA 2020 E BE-SË .....	7
2.2.4	OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË MIJËVJEÇARIT TË KB .....	7
2.2.5	KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT .....	8
2.3	PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE VSM NË KOSOVË .....	9
2.3.1	Informata lidhur me historikun e Kosovës.....	9
2.4	HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE .....	10
2.4.1	LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR .....	10
2.4.2	LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË MJEDISIT .....	11
2.5	PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME.....	11
2.5.1	ANALIZA MJEDISORE E VENDIT TË KOSOVËS. VLERËSIMI I SHPENZIMEVE TË DEGRADIMIT MJEDISOR, SHQYRTIMI INSTITUCIONAL DHE SHQYRTIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE LIDHUR ME MJEDISIN .....	11
2.5.3	STRATEGJIA QEVERITARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2011 -2020. 13	
2.5.4	OPSIONET E QËNDRUESHME ENERGJETIKE PËR KOSOVËN. ANALIZË E MUNDËSISË SË SIGURIMIT TË BURIMEVE DHE KOSTOJA E TYRE .....	13
2.5.5	PLANI HAPËSINOR PËR KOSOVËN 2010-2020+ .....	14
2.5.6	PLANI PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT .....	15
2.5.7	PARKU NACIONAL "MALET E SHARRIT" – PLANI ZHVILLIMOR HAPËSINOR .....	16
2.5.8	RISHIKIMI I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR HIDROCENTRALIN E ZHURIT .....	16
<b>III.</b>	<b>PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRIZRENIT PZHKP 2025</b> .....	<b>17</b>
<b>IV.</b>	<b>PËRSHKRIMI I MJEDISIT BAZIK</b> .....	<b>18</b>
4.1	PASQYRA E PËRGJITHSHME.....	18
4.2	TOPOGRAFIA .....	20
4.3	BURIMET E UJIT .....	20
4.4	BURIMET MINERALE.....	20
4.5	GJELOGJIA DHE HIDRO-GJELOGJIA .....	20
4.6	KUSHTET KLIMATIKE.....	21
4.7	VLERAT NATYRORE.....	21
4.8	MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS .....	21
4.9	MENAXHIMI I UJËRAVE DHE I KANALIZIMIT .....	22
4.10	MENAXHIMI I MBETURINAVE .....	23
4.11	TRASHËGIMIA KULTURORE.....	23
4.12	DEMOGRAFIA DHE PUNËSIMI .....	24
4.13	EKONOMIA .....	25
<b>V.</b>	<b>AFATI KOHOR I VSM</b> .....	<b>25</b>
5.1	QASJA PJEËMARRËSE E PROCEDURËS VSM .....	25
<b>VI.</b>	<b>FAZAT E VSM DHE METODOLOGJIA</b> .....	<b>26</b>
6.1	SHOSHITJA .....	26
6.2	KRIJIMI I FUSHËVEPRIMIT .....	26
6.2	OBJEKTIVAT, QËLLIMET DHE INDIKATORËT.....	28
<b>VII.</b>	<b>VLERËSIMI MJEDISOR I PZHKB</b> .....	<b>30</b>
7.1.1	SKENARI I MOS-BËRJES ASGJË .....	32
7.1.2	ZBATIMI I PLOTË I SKENARIT TË PZHKB 2025.....	32
7.1.3	SKENARI I NDARJES SË INTEGRUAR FUNKSIONALE NË ZONA .....	33
7.3	MASAT LEHTËSUJËSE.....	40
<b>VIII.</b>	<b>PËRFUNDIM</b> .....	<b>41</b>
<b>IX.</b>	<b>MONITORIMI</b> .....	<b>42</b>
<b>X.</b>	<b>REFERENCAT</b> .....	<b>43</b>

## TABELA E FIGURAVE

Figura 2.3.1.1Vendndodhja e Kosovës.....	9
Figura 2.5.5.1Zonat e veprimit të strategjisë. Plani hapësinor i Kosovës, 2010 .....	15
Figura 2.5.8.1Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit PZHKP 2025. Harta e Planit Zhvillimor, e përfunduar në pajtim me shqyrtimin e komenteve më 2012 .....	18
Figura 2.5.8.1Vendndodhja e Komunës së Prizrenit në Kosovë .....	19
Figura 2.5.8.1Rrejtja e ujësjetillësive në Prizren (PZHKP 2025).....	22
Figura 2.5.8.1Ndarja e Menaxhimit të Mbeturinave në Prizren (sasia e mbeturinave në ditë).....	23
Figura 7.1.2.1Ilustrimi i konceptit të zhvillimit hapësinor policentrik (ZHKP 2025).....	33
Figura 7.1.3.1 Ilustrimi i skenarit të tretë. Ngjyra kafe e mbyllur tregon hapësirat aktuale të banimit, ngjyra e kafe e hapur tregon hapësirat e mundshme të banimit dhe e hirta tregon hapësirat e mundshme industriale (bazuar në analizën PAH). .....	34

## TABELA E TABELAVE

Tabela 2.5.8.1Proporcioni i shfrytëzimit të tokës në Prizren.....	21
Tabela 2.5.8.1Popullsia në rajonet e Prizrenit .....	24
Tabela 2.5.8.1 Objektivat e propozuara:.....	29
Tabela 7.1.3.1 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi <i>trashëgimia kulturore do të ruhet dhe përmirësohet</i> .....	35
Tabela 7.1.3.2 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi <i>trashëgimia natyrore do të ruhet dhe të përmirësohet</i> .....	36
Tabela 7.1.3.3 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi <i>do të sigurohet mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve</i> .....	36
Tabela 7.1.3.4 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, parimi <i>Përfshirja sociale, barazia sociale dhe cilësia e jetesës</i> .....	37
Tabela 7.1.3.5 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, parimi <i>Vitaliteti ekonomik</i> .....	38
Tabela 7.1.3.6 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi <i>do të krijohen mjedisi tërheqëse për jetesë</i> .....	39
Tabela 7.1.3.7 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi <i>do të sigurohet transporti dhe rrejtja infrastrukturor efektiv dhe i integruar në hapësirë</i> . .....	39

# I. PËRMBLEDHJE

Raporti i vlerësimit aktual strategjik të mjedisit (VSM) është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të VSM për planin zhvillimor komunal të Komunës së Prizrenit (PZHK/PZHKP2025). Është rezultati kryesor i VSM dhe përvijon zbulimet e procesit të vlerësimit. PZHK është dokument i parashikuar me statut i përgatitur në emër të autoriteteve lokale të Prizrenit me mbështetjen e ofruar nga UN-Habitat në Kosovë.

Direktiva Evropiane mbi VSM (2001/42/EC) është adoptuar në legjislacionin e Kosovës nga Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik të Mjedisit më 2010. Sipas atij ligji, qëllimi i Ligjit mbi VSM është të sigurojë identifikimin dhe vlerësimin e pasojave mjedisore gjatë përgatitjes dhe para aprovimit të planeve dhe programeve të caktuara, futjen në listë nga ana e ligjit të planeve zhvillimore komunale si ato për të cilat kërkohet me statut që të kryejnë VSM (për shkak të këtij fakti në vlerësimin aktual nuk është bërë procesi i shoshitjes për ta vlerësuar nëse plani është objekt i VSM). Legjislacioni i Kosovës VSM zbaton parimin e përgjithshëm që procesi VSM duhet të kryhet paralelisht me procesin e vlerësuar për përgatitjen e planit dhe duhet të përfundohet para aprovimit të planit në mënyrë që t'i përfshijë në plan ndryshimet ose korrigjimet e nevojshme. Për shkak të faktit që PZHK i Prizrenit është përgatitur (nuk është miratuar përfundimisht) para se të hyjë në fuqi Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit, procesi aktual VSM është kryer pas përgatitjeve të PZHKP 2025 (para miratimit përfundimtar nga komuna), procesi ka vazhduar prej muajit maj deri në tetor 2012.

Faza e parë e këtij VSM ishte ajo para-vlerësuese, në të cilën u përfshi analiza e planeve dhe e programeve të tjera përkatëse nga nivele të ndryshme të qeverisjes (ndërkombëtare, kombëtare, lokale, nën-lokale) dhe mbledhja e të dhënave bazike për mjedisin. Sipas atyre informatave, në fazën para-vlerësuese u nënvizuan një numër i çështjeve të cilat janë shqetësuese dhe vendimtare për zhvillim të qëndrueshëm brenda hapësirës së Prizrenit, siç është cilësia e ujërave nëntokësore dhe atyre sipërfaqësore, trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave të ngurta dhe modelet e shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës. Në kuadër të fazës para-vlerësuese të VSM u propozuan tri alternativa mjedisore që të analizohen edhe më tej gjatë fazës vlerësuese të VSM – skenari zero /skenari i të mos bërit asgjë, zbatimi i plotë i skenarit PZHK dhe skenari i ndarjes së integruar funksionale në zona.

Gjatë fazës para-vlerësuese u përgatitën po ashtu objektivat mjedisore, qëllimet dhe treguesit në mënyrë që të parashikohen ndikimet dhe të përshkruhet dhe mbikëqyret ndryshimi i PZHKP 2025 në mjedis. Objektivat ndahen në katër grupe: I biodiversiteti, peizazhi dhe shfrytëzimi i tokës, II menaxhimi i mbeturinave të ngurta, III mbrojtja e ujit dhe IV ndryshimi i klimës dhe efikasiteti i energjisë. Ato në pjesën më të madhe karakterizohen nga qëllimi për ta përmirësuar gjendjen aktuale të mjedisit në Prizren, pjesa më e madhe e treguesve dhe e objektivave janë të matshëm dhe ato duhet të shfrytëzohen herë pas here për ta mbikëqyrtë përparimin e arritjes së objektivave të caktuara.

Gjatë fazës së vlerësimit është vlerësuar mënyra e ndikimit të zbatimit të PZHKP 2025 në gjendjen mjedisore dhe cilat aspekte duhet të merren parasysh ndërsa plani do të zbatohet për t'i zvogëluar rreziqet e mundshme mjedisore. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet gjetjes së vendndodhjes së zonave të reja zhvillimore, si industriale ashtu edhe të banueshme. Është e mundshme, që intensifikimi i zonave aktuale industriale është më i qëndrueshëm se sa krijimi i të rejave, meqë tashmë ekziston infrastruktura përkatëse, objektet e reja industriale duhet të vendosen me kujdes dhe në mënyrë kompakte për ta mundësuar mbledhjen e ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe si rrjedhojë edhe hapësira e mjedisit e cila është nën ndikim do të jetë më e vogël se në rastin e disa zonave të ndryshme industriale. Nëse vlerësohet që objektet e planifikuara industriale ose objektet e tjera do të krijojnë një burim shtesë ndotës të vendit, sidomos për ujin, nevojitet vendosje e mjeteve dhe e masave përkatëse (objekte të duhura për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza/të mbeturinave, sisteme për filtrimin e ajrit, etj.) në pajtim me objektet industriale të planifikuara me kujdes. Kur është fjala për hapësirat e reja ose të zgjeruara të banimit, është me rëndësi të kihet parasysh që këto do të vendosen në atë mënyrë që të garantohet cilësia e lartë e jetesës për banorët e mundshëm dhe në anën tjetër që ndikimet e mundshme negative të krijimit të vendbanimit të ri në mjedisin natyror do të jenë sa më të vogla që është e mundur. Një planifikim i duhur i infrastrukturës përkatëse (menaxhimi i mbeturinave/ujërave të zeza, infrastruktura energjetike, kushtet për transport efektiv dhe të qëndrueshëm, etj.) për zonat e reja të banimit ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve të mundshme mjedisore. Çështja jetike mjedisore gjatë zbatimit të planit është shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, përveç nevojës për mbrojtjen e peizazheve të vlefshme, hapësirave bujqësore, të tokës dhe të burimeve të ujit gjatë krijimit të zonave të reja zhvillimore, ekziston nevoja që të tërhiqet vëmendja tek burimet minerare meqë shfrytëzimi i minierave është aktivitet ekonomik që ndikon fuqishëm në burimet natyrore dhe

në peizazh. Edhe pse nuk ka të dhëna adekuate lidhur me burimet minerale të Prizrenit, sipas njohurisë së tanishme ekzistojnë burime të ndryshme minerale dhe mund të paraqitet interesimi për miniera brenda zonës. Përmes mbrojtjes së modeleve të balancuara të shfrytëzimit të tokës me PZHK aktual dhe me dokumentet e tjera hapësinore është e mundur që të shmangen dhe të zvogëlohen ndikimet e mundshme negative në mjedis. Hapësirat zhvillimore të planifikuara dhe të zbatuara si duhet (si ato të banimit ashtu edhe ato industriale) ndihmojnë në uljen e humbjes së biodiversitetit dhe në mbrojtjen e vendbanimeve të vlefshme. Po ashtu ofron mundësi për vendosjen e infrastrukturës përkatëse dhe për ngritjen e sistemeve për parandalimin e ndotjes nga kanalizimi dhe mbeturinat. Në rastin e PZHK të Prizrenit, është me rëndësi të përmendet që në nivel të qeverisjes lokale nuk kanë mundur të trajtohen plotësisht të gjitha çështjet thelbësore të mjedisit (d.m.th. mbrojtja e ujit, menaxhimi i mbeturinave të ngurta). Autoritetet nacionale duhet të kryejnë më shumë aktivitete të përgjithshme planifikuese për çështjet komplekse të ndotjes së shkaktuar nga vatra (deponia) dhe burimet e përgjithshme (kanalizimi i patrajtuar).

PZHKP2025 përfshin propozimet për projektet e mëtejshme zbatuese kryesisht për 2-5 vjetët e ardhshëm, janë vlerësuar ndikimet e mundshme të të gjitha propozim projekteve. Përfundim i përgjithshëm i vlerësimit të sugjerimeve për zbatim është që nuk parashihet asnjë ndikim i madh negativ mjedisor. Kjo pjesërisht shkaktohet nga fakti që projektet e zbatimit janë goxha të përgjithshme për nga natyra dhe janë pjesë e shumë propozimeve për përgatitjen e planeve dhe të programeve të mëtejshme për zonën e Prizrenit. Në mesin e projekteve, në kuadër të matricës së vlerësimit, janë identifikuar disa prej tyre që kanë ndikim të fuqishëm ose shumë të fuqishëm mjedisor. Janë analizuar si aspektet pozitive ashtu edhe ato negative në mjedis së bashku me ndikimet ekonomike dhe ndikimet e tjera të mundshme relevante. Nga aspekti pozitiv do të mund të përmendet plani për zhvillimin e turizmit natyror, plani për menaxhimin e shtratit të lumit, ndërtimi i objekteve të trajtimit dhe udhëzime për planifikim/projektim të qëndrueshëm të banimit. Është vlerësuar që projektet siç janë projekti për zhvillim bujqësor, projekti për zonën bujqësore industriale dhe projekti për qendrën e skijimit në Prevallë mund të përfshijnë ndikim, prej atij të moderuar deri te ai i fuqishëm, negativ në mjedis, prandaj në mënyrë që të arrihet përfitimi i prituro-shoqëror-ekonomik ato duhet të zbatohen me kujdes duke i pasur parasysh ndikimet mjedisore dhe masat përkatëse lehtësuese. Qëllimi i kësaj të fundit është shmangia ose lehtësimi i ndonjë ndikimi të mundshëm negativ në mjedis. Zgjedhja e masave më të përshtatshme të lehtësimit në një proces të vazhdueshëm gjatë tërë periudhës së zhvillimit të planit dhe duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë të të gjithë aktorëve përkatës (vendimmarrësit, ekspertët, investitorët, banorët vendas, OJQ-të). Raporti aktual propozon marrjen parasysh të një grupi masash lehtësuese nëse do të planifikohen dhe të krijohen zona të reja industriale, atraksione turistike, vendbanime ose objekte infrastrukture.

Në përfundimin e përgjithshëm të VSM thuhet që plani i vlerësuar për zhvillimin komunal i shërben qëllimit të përmirësimit të gjendjes aktuale shoqëro-ekonomike dhe asaj mjedisore dhe nuk përfshin ndonjë ndikim të madh negativ në mjedis. Fakti që plani PZHK i vlerësuar është përgatitur dhe mbas gjase do të aprovohet vetvetiu ka ndikim pozitiv në mjedis. Ky dokument shumë gjithëpërfshirës me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave aktuale dhe me gjendjen e komunës do të formojë bazë të mirë analitike për proceset e mëtejshme të qëndrueshme vendimmarrëse. Çështja e qëndrueshmërisë është përfshirë si politikë me prioritet në strategjinë – objektivat e zonës, ndërsa dispozitat e zbatimit kanë rrjedhur në përputhje me rrethanat.

Prej tre skenarëve alternativë të propozuar për mjedisin (të mos bëhet asgjë, zbatim i plotë dhe skenari i kombinuar) skenari i integruar i ndarjes funksionale në zona është propozuar si skenar i sugjeruar. Sipas asaj alternative, PZHK aktual do të plotësohet me një kornizë më specifike hapësinore për ta lehtësuar procesin e zbatimit të PZHK. Ajo propozon që me PZHK do të caktohet një numër i përshtatshëm i hapësirave për zhvillim që gjenden në vende të përshtatshme në mënyrë që të ofrojnë perspektiva të qarta zhvillimore për të ardhmen dhe direktiva hapësinore për dokumentet planifikuese të nivelit më të ulët. Ajo po ashtu parandalon që zhvillimet (që kanë mundësi të kenë ndikime negative në mjedis) të vendosen në mënyrë të gabuar ose tepër rrallë dhe ndihmon në planifikimin dhe vendosjen e infrastrukturës së nevojshme, si edhe të shërbimeve publike dhe private. Me qëllim të njëjtë – për të krijuar bazë efektive për zbatimin e planit – sugjerohet që ose para aprovimit përfundimtar të PZHK ose gjatë korrigjimit të ardhshëm të planit lista e projekteve do të korrigjohet dhe do të ndryshohet me projekte afatmesme dhe afatgjata me organet përgjegjëse për t'i arritur objektivat strategjike të planit. Përfshirja e hapave të qartë do t'i mbrojtë arrijtet e objektivave si ekonomike ashtu edhe mjedisore të planit.

## II. HISTORIKU

### 2.1 HYRJE

Planifikimi hapësinor ka rol jetik gjithnjë më të madh për vendet dhe rajonet. Planifikimi hapësinor mund të ndihmojë në ofrimin e përfitimeve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore. Nëse drejtohet si duhet, ai është një mjet i rëndësishëm për promovimin e investimit, të zhvillimit, të përmirësimeve mjedisore dhe cilësisë së jetës (Kombet e Bashkuara ..., 2008; 40). Prandaj është thelbësore të sigurohet që procedurat përkatëse planifikuese në të gjitha nivelet qeverisëse dhe aktivitetet zhvillohen në atë mënyrë që t'i mbështesin perspektivat zhvillimore të ekuilibruara mirë. Duke e pasur parasysh ndikimin e konsiderueshëm të vendimeve të planifikimit hapësinor, nuk mund të paramendohet zhvillimi i krijimit të politikave në këtë zonë pa i marrë parasysh ndërlidhjet ndërmjet fushave të politikave, të territoreve dhe të gjithë aktorëve relevantë. Prandaj është e qartë që në planifikimin hapësinor nuk mund të nënvlerësohet roli i cilitdo nivel të qeverisjes – ndërkombëtar, kombëtar, rajonal apo lokal.

VSM është proces për bërjen e vlerësimit në fazën më të hershme të përshtatshme të ndikimit në mjedis dhe të pasojave dhe të politikave, të nismave të planeve ose të programeve. Qëllimi është të sigurohet që pasojat mjedisore të planeve ose të programeve vlerësohen gjatë përgatitjes së tyre dhe para se të aprovohen përfundimisht. Ai po ashtu i jep rast opinionit dhe palëve të tjera të interesuara që të komentojnë dhe të jenë të informuar lidhur me vendimet dhe me mënyrën e marrjes së tyre. VSM shpesh përkufizohet duke e shfrytëzuar përkufizimin nga Therivel si 'proces formal, sistematik dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të efekteve të një politike, plani ose programi të propozuar ose të alternativave të tyre, përfshirë raportin me shkrim lidhur me gjetjet e atij vlerësimi dhe duke i shfrytëzuar gjetjet në vendimmarrjen me përgjegjësi publike' (Therivel dhe të tjerët 1992).

Raporti aktual VSM është përgatitur si dokument përfundimtar i procesit të vlerësimit strategjik të mjedisit për komunën e Prizrenit. Plani zhvillimor komunal (PZHK) është rezultati kryesor i VSM i cili përvijon gjetjet e procesit të vlerësimit. PZHK është dokument i parashikuar me statut i përgatitur në emër të autoriteteve lokale kushtetuese me mbështetjen e ofruar nga UN-Habitat Kosovë.

Direktiva Evropiane mbi VSM (2001/42/EC) është aprovuar në legjislacionin e Kosovës përmes Ligjit për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit më 2010. Sipas atij ligji, qëllimi i Ligjit mbi VSM është të sigurojë identifikimin dhe vlerësimin e pasojave mjedisore të planeve dhe programeve të caktuara gjatë përgatitjes së tyre dhe para se të aprovohen ato. Për planet dhe programet e përgatitura nga organet e parashikuara me statut dhe të cilat mbas gjase do të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedis do të nevojitet të zhvillohet një VSM në rastet kur përgatitja e planeve dhe programeve të tilla fillon pas asaj date.

### 2.2 LEGJISLACIONI, PLANET, PROGRAMET, KONVENTAT DHE PROTOKOLLET NDËRKOMBËTARE

#### 2.2.1 DIREKTIVA VSM E BE-SË

Direktiva e Këshillit 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis (Direktiva VSM) u aprovua më 27.06.2001. Direktiva VSM vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Direktiva VSM nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian ..., 2001) thotë që 'planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legjislative, rregulluese ose administrative'.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet të cilat janë të shënuara në Direktivë si vijon:

- 'përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujit, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzimin të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve'.

Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse kanë efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativat e arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

### 2.2.2 DIREKTIVAT E TJERA TË BE-SË

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore dhe të qëndrueshmërisë (shih listën në Shtojcën 1). Sipas Marsden (2008) 'VSM ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti meqë vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme'.

### 2.2.3 STRATEGJIA 2020 E BE-SË

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legjislativë të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha<sup>1</sup> është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë 'zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës'. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve* dhe *Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si *Agjenda digjitale për Evropën*, *Unioni i përtëritjeve*, *Rinia në lëvizje*, *Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune* dhe *Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin po ashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji po ashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t'i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e përtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

### 2.2.4 OBJEKTIVAT ZHVILLIMORË TË MIJËVJEÇARIT TË KB

KB ka një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t'i sigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mblodhën në Nju Jork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si

<sup>1</sup> Informata të mëtejshme lidhur me strategjinë dhe përparimin e arritur në zbatimin e saj mund të gjenden në: [http://ec.europa.eu/europe2020/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm)

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit<sup>2</sup>. Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthimi mbarsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetët e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra<sup>1</sup>.

## 2.2.5 KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT

### KONVENTA ÅRHUS

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen ..., 1998) 'Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaji pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinionit të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.<sup>1</sup>

### KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi ..... Mjedisor, 1991) përcakton 'obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit'. Po ashtu i formulon 'obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve'. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

Siç thekson Marsden (2008), 'Protokolli i Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqë do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare

<sup>2</sup> Informata të mëtejshme lidhur me objektivat dhe përparimin e bërë në zbatimin e tyre mund të gjenden në: <http://www.un.org/millenniumgoals/bkgd.shtml>

që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008)'. Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (NMP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokollin po ashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të zhvillimit. Protokollin kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

## 2.3 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE VSM NË KOSOVË

### 2.3.1 Informata lidhur me historikun e Kosovës

Analiza strategjike mjedisore e REC për Kosovën (Rajonal ..., 2008; 5, 8,18) e përshkruan Kosovën me një hapësirë prej 10,887 kilometra katrorë. Ajo mbulon një sipërfaqe prej 1.1 milion hektarë. Rreth 430,000 hektarë janë të pyllëzuar (39.1%) dhe 577,000 hektarë klasifikohen si tokë bujqësore (52%). Prej kësaj të fundit, 31% janë kullosa dhe rreth 69% është tokë e lërueshme. Është pellg gjeografik në lartësi prej rreth 500 metrash, e rrethuar me bjeshkë dhe e ndarë në dy nën-rajone, me një vargmal qendror veri-jug, me madhësi dhe popullsi përafërsisht të barabartë. Është pjesë e rajonit të Evropës Juglindore (ose Ballkanit) dhe kufizohet me Serbinë në veri dhe në lindje, me Malin e Zi në perëndim, me Shqipërinë në jugperëndim dhe me IRJ të Maqedonisë në juglindje. Ka klimë kontinentale, të njohur për temperatura të skajshme dhe në dimër paraqiten shpesh anasjellje termike.

Figura 2.3.1.1Vendndodhja e Kosovës



Përqendrimi i specieve endemike lokale është në kufirin e Kosovës jugperëndimore, në verilindje të Shqipërisë dhe në veriperëndim të IRJ të Maqedonisë, domethënë në malet e Sharrit. Kjo zonë malore është e lidhur me Bjeshkët e Nemuna, Durmatorin dhe malet bregdetare Dinara dhe paraqet qendrën e biodiversitetit endemik në Ballkan. Territori i Kosovës ka një park nacional (Malet e Sharrit), dy parqe rajonale, 11 rezervate natyrore, 32 monumente të natyrës, etj. Megjithatë vetëm gjysmë për qind e territorit të saj është e mbrojtur.

Brenda kësaj hapësire të vogël ekziston një llojlojshmëri si e specieve po ashtu edhe e habitateve. Në Malet e Sharrit ekzistojnë më shumë se 2000 specie të florës enëzore. Është rreth 26% e florës së Ballkanit dhe 18 % e asaj evropiane. Kjo pasuri e specieve është një shembull i pasurisë së jashtëzakonshme të bimësisë. Analiza e shtrirjes së hapësirës tregon që më së shumti ka takson endemik (rreth 29 %) dhe nën-endemik (rreth 10%), që është pothuajse 40 % e florës endemike të Maleve të Sharrit. Këto shifra i vendosin Malet e Sharrit mu në qendër të shumëllojshmërisë së gjeneve dhe të specieve në Evropë dhe në botë. Kosova është relativisht e pasur me burime natyrore. Ka njërën prej rezervave më të mëdha të thëngjillit të shfrytëzueshëm (linjtit) në Evropë, plus mineralet e tjera. Po ashtu posedon biodiversitet shumë të pasur, të përqendruar në zonën përreth maleve të Sharrit në jugperëndim të Kosovës’.

Edhe pse parimi i zhvillimit të qëndrueshëm është i integruar në Strategjinë dhe Planin e Kosovës për Zhvillim (SPKZH), aktiviteti më i rëndësishëm zhvillimor lidhur me çështjet mjedisore do të mund të vlerësohej si Strategji e Kosovës për Mjedisin (SKM), e cila është aprovuar më 2004 nga Qeveria e Kosovës. Analiza e Kosovës për Mjedisin dhe Klimën e përgatitur nga Shkolla për Biznes, Ekonomi dhe Juridik, Departamenti i Universitetit të Goteborgut për Ekonomik, Njësia e Ekonomisë Mjedisore (Shkolla e.....,2008;9) përcakton objektivat afatgjate të strategjisë si vijon: ‘ përmirësimi i cilësisë së jetesës për njerëzit; shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i burimeve natyrore; dhe shmangia e efektit të dëmshëm në mjedis. SKM ka shtatë fusha strategjike: 1) ajrin (përfshirë ndryshimin klimatik dhe acidimin); 2) ujin; 3) tokën; 4) trashëgiminë natyrore; 5) biodiversitetin; 6) mbeturinat; dhe 7) menaxhimin e rrezikut dhe të katastrofave’. Në lidhje me ndryshimin e klimës disa prej prioriteteve janë themelimi i një trupi bashkërendues, monitorimi i emetimeve të gazrave të serrës dhe të qenit aktiv në diskutimet ndërkombëtare për ndryshimin e klimës. Prandaj ndryshimi i klimës përmendet nga pikëpamja e zvogëlimit jo nga ajo e përshtatjes. E njëjta gjë vlen edhe për Planin e Veprimit të Kosovës për Mjedisin (PVKM), i cili është lëshuar nga MMPH në maj 2006 dhe është aprovuar nga IPVQ në janar 2007. Ai nënvizon që PVKM duhet të ndihmojë në forcimin e procesit të ardhshëm të hyrjes së Kosovës në BE ‘

## 2.4 HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE

### 2.4.1 LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Ligji i ri për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji nr. 03/L-106) duke pasur si qëllim kryesor sipas Nushi (2011) ‘rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban’. Gjatë përgatitjes së VSM aktuale drafti i ri i Ligjit për Planifikim Hapësinor ishte duke u përgatitur dhe ishin duke u bërë konsultime me palët e interesuara me perspektivën që të hyjë në fuqi në fund të vitit 2012. Sipas këtij akti ligjor, planifikimi hapësinor duhet ‘t’i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet ‘t’i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet ‘t’i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet’. Në mesin e parimeve është po ashtu edhe përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur.

Parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar Komisionin e Ekspertëve të Planifikimit (në nivelin lokal) dhe Këshillin për Planifikim Hapësinor (në nivel kombëtar). Në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 5 vjetëve dhe ta përfshijë një plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatave brenda komunës. Po ashtu duhet ta përfshijë një përmbledhje të shkurtër të ndikimeve shoqëro-ekonomike dhe mjedisore.

Nushi (2011) identifikon që institucioni kryesor që është përgjegjës për zbatimin e ligjit të sipërpërmendur në nivel kombëtar është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) e cila ‘në pajtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikat për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor. MMPH është po ashtu përgjegjëse për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin’.

Në kuadër të sistemit të Kosovës të planifikimit në dy nivele, niveli i qeverisjes lokale ka rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve dhe të kërkesave planifikuese të përcaktuara nga Ligji për Planifikimin Hapësinor. Sipas Tofaj dhe të tjerët (2010; 1137) 'komunat e Kosovës luajnë një rol të rëndësishëm në udhëheqjen e komuniteteve të tyre, duke krijuar pasuri dhe duke imponuar identitetin lokal. Shoqëria duhet të ketë udhëheqje të fuqishme që i bashkon të gjitha palët e interesuar relevante, përfaqësuesit e komunitetit dhe të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare të cilat mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë duke u bazuar në një vizion të përgjithshëm. Ky është njëri nga aktivitetet kryesore që pritet ta kryejnë komunat. Është interesante të vihet re që sipas rrethanave aktuale roli i agjencive ndërkombëtare (siç është UN-HABITAT) është më i madh se që pritet për shkak të granteve të donatorëve, deri në atë pikë sa që konsiderohet palë me interes në proces. Megjithatë, me kalimin e kohës dhe deri sa komunat të tregojnë nivele të rritura të kapacitetit profesional dhe financiar, roli i agjencive ndërkombëtare do të duhet të zvogëlohet vetëm për t'i stimuluar proceset dhe projektet. Përvoja në planifikim në të kaluarën para konfliktit (ku pjesa më e madhe e pasurisë ka qenë pronë shtetërore) ishte që pushteti lokal i lehtësonte dhe i realizonte të gjitha këto aktivitete vetë. Ndërsa, planifikimi bashkëkohor strategjik promovon qasjen sipas së cilës pritet që qeveria lokale ta kryejë pjesën më të madhe të aktiviteteve të saj në partneritet me sektorin privat dhe me agjencitë ndërkombëtare, ndërsa i përfshin zërat e komunitetit në mënyrë konsekuente '.

#### 2.4.2 LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK TË MJEDISIT

Ky ligj nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e planeve dhe e programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi përkatës duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet e tij. Raporti NMV identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i planit ose programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në ligj në mënyrë që t'iu ofrojnë qasje në dokumentet VSM organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM është një objekt për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesat e posaçme për rastet e këshillimeve ndërkufitare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Po ashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kriteret e caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve VSM.

### 2.5 PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME

Përveç legjislationit dhe planit nacional hapësinor të përmendur më parë, strategjia për mjedisin dhe plani i veprimtimit për mjedisin janë disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

#### 2.5.1 ANALIZA MJEDISORE E VENDIT TË KOSOVËS. VLERËSIMI I SHPENZIMEVE TË DEGRADIMIT MJEDISOR, SHQYRTIMI INSTITUCIONAL DHE SHQYRTIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE LIDHUR ME MJEDISIN

Një analizë gjithëpërfshirëse dhe e azhurnuar e përgatitur nga Banka Botërore është prezantuar në qershor 2012. Objektivi i kësaj analize është të raportojë lidhur me gjendjen e mjedisit dhe çështjet kryesore mjedisore dhe ta vlerësojë koston shëndetësore dhe ekonomike të këtyre çështjeve. Kostot maten si për shembull ndikimet në shëndet (sëmundjet dhe vdekshmëria e hershme) dhe pastaj shprehen si kosto vjetore të dëmit ekonomik në euro dhe si pjesë e bruto prodhimit vendor (GDP). Duke i caktuar vlera monetare të degradimit të mjedisit, analiza (Banka Botërore, 2012) këtu arrin katër rezultate kryesore: 'siguron një mekanizëm të dobishëm për renditjen e shpenzimeve relative sociale të formave të ndryshme të degradimit dhe ofron një mjet për dhënien prioritet problemeve të mjedisit. Ai ju ofron krijuesve të politikave një instrument për integrimin e mjedisit në vendimarrjen ekonomike. Ai shpreh shpenzimet e dëmeve si pjesë e GDP, duke e mundur krahasimin me indikatorët e tjerë ekonomikë'. Ju ofron aktorëve të ndryshëm një mjet për diskutimin e rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit në aspektin ekonomik – të dobishme për të vendosur lidhur me mënyrën e ndarjes së burimeve të pakta dhe për ta ngritur vetëdijen e "çmimit të të bërit asgjë" lidhur me problemet urgjente të mjedisit.

Sipas raportit (Banka Botërore, 2012) kostoja vjetore e degradimit të mjedisit në Kosovë vlerësohet të jetë 123 milionë €– 323 milionë € më 2010, me një vlerësim mesatar prej 221 milionë €. Kjo kosto është e barasvlershme me 2.9–7.7 për qind të GDP, me një mesatare prej 5.3 për qind. Kostot janë tregues dhe jo shifra të sakta, meqë ka mungesa të mëdha të të dhënave, disa të dhëna nuk janë azhurnuar së fundi – për shkak të historisë së trazuar të vendit – dhe nuk mund të jepen shifra në para të të gjitha ndikimeve. Me kostot vjetore prej 221 milionë € të degradimit të mjedisit, Kosova ballafaqohet me ndikime serioze shoqërore dhe ekonomike për shkak të aktiviteteve të menaxhuara dobët dhe do të mund të arrinte përfitime të mëdha nga veprimet riparuese për mbrojtjen dhe ruajtjen e cilësisë së mjedisit. Kostoja e ndotjes së jashtme të ajrit në zonat urbane, ku ndikimet më domethënëse të cilat i shkaktohen shëndetit vlerësohen të jenë çështje mjedisore me ndikimin më të madh – kostot e vlerësuara të dëmit sillen prej 37 milionë euro në 158 milionë euro në vit (0.89-3.76 për qind e GDP). Vlerësohet se ndotja e ajrit shkakton 835 të vdekjeve të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 pranime në spital dhe 11,600 vizita urgjente çdo vit. Çështje të tjera të rëndësishme mjedisore në Kosovë të cilat janë analizuar dhe vlerësuar më tepër në Kosovë në kuadër të shqyrtimit janë cilësia e ujit, mbeturinat e ngurta, burimet e pyjeve/të tokës dhe minierat/energji e prodhimit.

## 2.5.2 STRATEGJIA QEVERTARE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2011 – 2020

Strategjia e përgatitur dhe e nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) më 2011 është shpallur të jetë strategjia e parë për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Objektivi kryesor i Strategjisë (Ministria e ..., 2011) është që të 'krijohë masa me anë të të cilave Republika e Kosovës do të duhej ta zvogëlonte sasinë e mbeturinave të cilat i krijon aktualisht si edhe menaxhimin e mbeturinave në mënyrë të qëndrueshme'. Strategjia i përcakton direktivat dhe objektivat në fushën e menaxhimit të mbeturinave për periudhën prej dhjetë vjetësh (2011-2020), në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave dhe mundësitë ekonomike. Përqendrimi është në zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave, në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave në burim dhe në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të hedhen, në zhvillimin e infrastrukturës vendosjen e një qasjeje të integruar për menaxhimin e mbeturinave, në zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat, në kontribuimin e rritjes së punësimit në vend dhe në edukimin e zyrtarëve, të ekspertëve dhe të popullit. Strategjia është një dokument në të cilin përfshihen nivelet administrative qendrore dhe lokale dhe sektorët e ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë në fushën e ujërave, të minierave, shëndetësisë, veterinarisë, planifikimit hapësinor, ndërtimitarisë, etj. Ky dokument, i cili bazohet në dokumentet dhe direktivat e BE-së, do të sjellë rezultate pozitive kur të fillojnë bisedimet për anëtarësim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së dhe po ashtu do ta përgatis vendin për sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Dokumenti paraqet parimet themelore (të paguarit e ndotësve, etj.), analizon kornizën ligjore dhe tendencat evropiane dhe përmend vizionin dhe prioritetet. Strategjia përfshin një ide të përgjithshme të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave ndërsa aspektet më të rëndësishme janë vetëdijesimi shumë i ulët dhe dallimi i madh në shkallën e sistemeve funksionuese për mbledhjen e mbeturinave ndërmjet zonave urbane (90%) dhe të atyre rurale (10%). Ekziston një pasqyrë lidhur me aktorët dhe strukturat administrative relevante. Strategjia cakton objektivat që 90% (gjithsej) e mbeturinave komunale duhet të mbledhen deri më 2020 dhe bilanci aktual ndërmjet mbeturinave të trajtuara dhe të atyre të hedhura (10/90) duhet të jetë 40/60 deri më 2020. Parashikohet që deri më 2020 të gjithë qytetarët duhet të përfitojnë nga mbledhja e organizuar e mbeturinave, përqindja e mbeturinave komunale të destinuar për trajtim të mëtejshëm dhe riciklim. Sipas strategjisë rrejtja e objekteve dhe i pajisjeve për menaxhim komunal të mbeturinave duhet të përkufizohet në Planin Zhvillimor Komunal. Sipas Strategjisë, 'investimi i plotë i vlerësuar për adresimin e problemeve aktuale dhe për plotësimin e objektivave arrin në 531 milionë euro. Prej kësaj shume 10 milionë euro ju dedikohen masave të përgjithshme dhe zvogëlimit të mbeturinave, 274 milionë euro mbeturinave komunale, 247 milionë euro për llojet e tjera të mbeturinave duke i pasur parasysh mbeturinat nga ndërtimi, objektet për trajtim mekanik-biologjik dhe termik të mbeturinave dhe zgjidhjet e tjera teknike për mënjanimin e mbeturinave të patrajuara si zgjidhje përfundimtare'.

### 2.5.3 STRATEGJIA QEVERTARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2011 -2020

Është përgatitur nga MMPH gjatë periudhës 2009-2011. Sipas dokumentit (Ministria e ...) 'në mënyrë që ta ruajë biodiversitetin, ta ndalojë humbjen e habitatit dhe t'i plotësojë standardet ligjore të BE-së për mjedisin, strategjia përcakton një vizion për ta siguruar pasurinë unike të bimëve, të kafshëve dhe të peizazhit që do t'i kontribuonte rritjes së mirëqenies për popullin e Kosovës'. Janë 4 objektiva strategjike:

**'Objektivi Strategjik 1:** Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së dhe zbatimimi i efikas i saj.

**Objektivi Strategjik 2:** Konservimi, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes për speciet e bimëve dhe të kafshëve, habitatet natyrore dhe peizazhet karakteristike në ekuilibrin natyror.

**Objektivi Strategjik 3:** Të siguruarit e mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët e tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve.

**Objektivi Strategjik 4:** Përkrahja e arsimimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin.'

Strategjia përmban një listë të gjatë të zgjidhjeve ose të objektivave strategjike që duhet t'i adresojnë problemet e identifikuar, mundësitë, kërcënimet dhe çështjet e tjera. Disa prej këtyre objektivave strategjike janë përmendur në përgjithësi dhe pak a shumë janë si programe për të cilat nevojitet periudhë më e gjatë e zbatimit. Aktivitetet e identifikuar në kuadër të Planit të Veprimit do të zbatohen përmes projekteve specifike, për secilin aktivitet do të nevojitet një projekt i cili paraqet bazë zbatimi për financimin ose ndarjen e burimeve financiare. Pohohet se është e qartë që për zbatimin e listës së plotë veprimeve do të nevojitet një periudhë e gjatë kohore, ndoshta 10 apo më shumë vite. Gjatë procesit përgatitor, janë bërë shumë përpjekje për ta caktuar prioritetin e listës, duke e pasur parasysh urgjencën, kërcënimin, mundësinë, financimin dhe mundësinë për sukses. Janë bërë përpjekje serioze për zberthimin e programeve në veprime specifike brenda programeve. Për zonën e Prizrenit strategjia është me rëndësi sepse ajo merret me mbrojtjen lëshuar për parkun kombëtar Malet e Sharrit, thekson nevojën për regjistrimin e habitateve (fauna dhe flora), për ta aprovuar menaxhimin dhe për ta përkrahur turizmin e qëndrueshëm.

### 2.5.4 OPSIONET E QËNDRUESHME ENERGJETIKE PËR KOSOVËN. ANALIZË E MUNDËSISË SË SIGURIMIT TË BURIMEVE DHE KOSTOJA E TYRE

Analiza është përgatitur nga Grupi për Energjetikë dhe Burime i Shkollës Goldman për Politika Publike, Laboratori për Energji të Përtëritshme dhe të Përshtatshme, Universiteti i Kalifornisë, Berkli dhe është prezantuar në janar 2012. Ky vlerësim (Energjia..., 2012) 'është një trajtim analitik i opsioneve energjetike të cilat ekzistojnë sot dhe që mund të krijohen përmes hetimit të efikasitetit të ri energjetik, të energjisë së përtëritshme dhe shfrytëzimit të urtë të burimeve të fosileve të lëndëve djegëse. Elementet kryesore të një plani të tillë progresiv energjetik për Kosovën, dhe ndoshta edhe më gjerë për Ballkanin, janë: krijimi i vendeve të punës dhe mbështetja e industrisë vendëse; ekspozimi i zvogëluar ndaj furnizimit me energji dhe rreziqet e çmimit përmes bashkërendimit dhe integritimit rajonal; dhe një përzjerje energjetike që zvogëlon rreziqet shëndetësore për njerëzit dhe mjedisin dhe lehtëson integrimin ekonomik në Bashkimin Evropian'. Analiza ofron një pasqyrë shumë gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale në sektorin e rrymës elektrike, ku aspektet negative të shfrytëzimit të madh të linjitet/thëngjillit ngjyrë kafe përshkruhen si efikasiteti i ulët dhe shkalla e lartë e emetimeve të CO2. Duke u bazuar në këtë analizë dhe duke e shfrytëzuar metodën e simulimit tre skenarët janë përshkruar dhe janë krahasuar në kuadër të analizës – skenari biznes si zakonisht, skenari bazik dhe skenari i karbonit të ulët. Analiza (Energjia..., 2012) thotë që 'mënyra biznes si zakonisht, që mbizotërohet nga shfrytëzimi i gjerë i thëngjillit të kualitetit të ulët, nuk është opsioni energjetik që kushton më së pakti për Kosovën duke e pasur parasysh koston shoqërore të gjenerimit termik. Mënyra e energjisë në të cilën mbizotëron thëngjilli po ashtu i ngarkon gjeneratat e ardhshme me një përzjerje të energjisë që as nuk është e qëndrueshme sa i përket mjedisit as nuk është mënyrë që e rritë krijimin e vendeve të punës. Mënyra e karbonit të ulët ekziston për Kosovën që integron shpërndarjen agresive të efikasitetit të energjisë, shfrytëzon energjinë e ujit të shkallës së madhe dhe të asaj të vogël, shfrytëzimi diellor, i biomasës dhe shfrytëzimi i gjerë i energjisë së erës ndërsa zvogëlon dëmin njerëzor dhe ekologjik. Kjo mënyrë deri sa dërgon 38% të kërkesës për energji përmes burimeve të ripërtëritshme, mundet po ashtu të ofrojë pothuajse 30% më shumë vende pune se mënyra biznes si zakonisht dhe e bën këtë në kursim të vlerësuar të koston prej 50% përkatëse për skenarin bazuar në raste në të cilin përfshihet termocentrali i ri. Dy zotime janë kryesore për suksesin e mënyrës së karbonit të ulët: 1) zbatimimi i programeve të efikasitetit të energjisë agresive (dhe zvogëlimi i humbjeve teknike) dhe mundësimi i politikave për ta bërë këtë; dhe 2) hulumtimi dhe zbatimimi i mundësive për shndërrimin e kapacitetit të hidro-energjisë në burim gjatë tërë vitit dhe zhvillimi i burimeve të erës ose i burimeve të tjera të energjisë së ripërtëritshme që mund t'i adresojnë kërkesat më të mëdha për energji, mundësisht duke e shfrytëzuar njëkohësisht erën dhe hidro-energjinë, dhe/ose për ta futur energjinë gjeotermike në përzjerjen e energjisë'.

### 2.5.5 PLANI HAPËSINOR PËR KOSOVËN 2010-2020+


Siç është thënë në PZHKP 2025 të Prizrenit, ky plan hapësinor është dokument që përkrahë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim të përsheptuar ekonomik dhe njëkohësisht duke i mbrojtur burimet, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Hartimi i planit hapësinor mbështetë shpërndarjen hapësinore të zhvillimit, në nivel kombëtar, komunal dhe urban dhe po ashtu hartimin e Strategjisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Kosovës. Vizioni i Kosovës, sipas planit, është të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji bashkëkohore, mundësi për arsimim për të gjithë dhe fuqi të kualifikuar punëtorë, një vend që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të atij të fqinjëve, me një shoqëri të hapur në të cilën përkrahet llojllojshmëria dhe shkëmbimi i ideve, duke i respektuar të drejtat e të tjerëve.

Konceptithemelor i zhvillimit hapësinor, sipas Planit Hapësinor të Kosovës, përkufizohet si koncept nyjor zhvillimor me elemente të korridorit. Koncepti i zhvillimit nyjor i referohet përqendrimit të zhvillimit të ardhshëm në shtatë qendrat e mëdha të Kosovës, dhe koncepti i korridorit i referohet zhvillimeve hapësinore përgjatë rrugëve, të cilat do të kontrollohen rreptësisht dhe nuk do të lejohen në tokën bujqësore të kategorisë I dhe IV. Ndryshe nga plani i mëparshëm hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës bën zhvillimin shoqëror, konservimin e trashëgimisë kulturore pjesë të parimeve kryesore të strategjisë së zhvillimit hapësinor. Në lidhje me këto koncepte dhe strategji të zhvillimit hapësinor, janë propozuar katër zona / rajone në të cilat Prizreni është qendër e “Kopshteve të Kosovës”. Rajoni gjendet në jug të Kosovës dhe në të bëjnë pjesë komuna e Suharekës, e Dragashit dhe e Prizrenit. Zona është e pozicionuar për turizëm kulturor, industri bujqësore dhe tregti dhe shërbim dhe Prizreni ka rol udhëheqës me vlerat e tij të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mundësitë për rekreacion dhe turizëm kulturor.

Strategjia për zhvillimin hapësinor është krijuar në zhvillimin e një rrjeti të fuqishëm të qyteteve me ndikim ekonomik, përmes burimeve njerëzore, rritjes së bazës së njohurisë, shfrytëzimit racional dhe të planifikuar të burimeve kulturore dhe natyrore, mundësive për qasje në infrastrukturën fizike, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës, barazisë shoqërore, të pasurit për qëllim garën rajonale si qytete, të gjitha këto të mbështetura nga kapacitetet organizative. Parimet kryesore të strategjisë së zhvillimit hapësinor janë paraqitur për temat në vijim:

- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban të zhvillimit ekonomik
- Zhvillimi dhe konservimi i burimeve natyrore
- Zhvillimi i lidhjeve strategjike.

Figura 2.5.5.1 Zonat e veprimit të strategjisë. Plani hapësinor i Kosovës, 2010



Burimi: MMPH, Plani Hapësinor i Kosovës

Objektivat e përgjithshëm për Prizrenit të cilat përmenden në plan janë:

- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike,
- Qeverisja dhe administrimi lokal efikas, për t'i mbështetur objektivat zhvillimore,
- Programi lokal për zhvillim ekonomik përmes përkrahjes së ndërmarreve të vogla dhe të mesme,
- Zhvillimi i pemëtarisë, vreshtarisë dhe bujqësisë,
- Zhvillimi i turizmit malor dhe kulturor, mbrojtja e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike.

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ përveç kësaj përshkruan një objektiv të përgjithshëm për zhvillimin e lidhjeve efektive brenda hapësirës urbane, ndër-urbane me pesë hapësirat e tjera dhe përtej tyre përmes zhvillimit të infrastrukturës rajonale (rruga, hekurudha, TI). Konservimi i burimeve natyrore është njëri prej parimeve më të rëndësishme në planin hapësinor të Kosovës duke e pasur parasysh humbjen e cilësisë së tokës bujqësore; ndotjen e lartë të mjedisit; shfrytëzimin joracional të burimeve dhe rritjen e pakontrolluar të vendbanimit. Marrja parasysh e trashëgimisë kulturore në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ të aprovuar rishtazi është posaçërisht një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm dhe strategjitë e konservimit të vendit. Në lidhje me këtë, Prizreni është një nyje e rëndësishme me trashëgiminë e tij të pasur historike dhe kulturore dhe me burimet mjedisore. Plani Hapësinor i Kosovës i jep Prizrenit rolin si “Qytet muze” t’i kontribuojë krijimit të kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillimin ekonomik lokal. Por ashtu ai udhëhiqet nga strategjia, nevojitet veprim i përqendruar në mbrojtjen e burimeve mjedisore dhe natyrore, kujdes për trashëgiminë kulturore dhe natyrore dhe përkrahje të tyre për zhvillimin e turizmit, mbrojtje të cilësisë së tokës bujqësore dhe përkrahje të prodhimeve vendore, mbrojtje të burimeve minerale dhe shfrytëzim racional të tyre, dhe po ashtu rritje e kontrolluar e vendbanimeve.

## 2.5.6 PLANI PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Plani për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit është produkt i Programit të Rehabilitimit të Zonës Historike të Prizrenit dhe përshkruhet gjerësisht në kuadër të PZHKP 2025. Sipas planit të vlerësuar, studimi i Planit për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit është kryer në kuadër të kornizës së protokollit të nënshkruar ndërmjet një OJQ-je suedeze, “Trashëgimisë Kulturore pa Kufi” dhe Qendrës për Planifikim dhe

Hulumtim Urban dhe të Mjedisit të Universitetit Teknik të Stambollit. Plani për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Zonës Historike të Prizrenit paraqet propozime të planifikimit në titujt e çështjeve fizike, të shfrytëzimit të tokës, transportit dhe atyre të mbrojtjes. Në propozimet e projektit plani ka përmirësuar direktivat për projektimin urban të cilat paraqitën propozimet strukturore edhe për shembujt arkitektonik monumental edhe për ata civil dhe të zbatimit të mbushjes. Për arkitekturën monumentale dhe civile, intervenimet janë përkufizuar në kuadër të parimeve të mbrojtjes dhe të ruajtjes. Për përdorimet e mbushjes propozimet strukturore janë nënvizuar me llojet e propozuara të ndërtimit i cili është në harmoni me arkitekturën tradicionale. Sipas planit për mbrojtje dhe zhvillim, duhet të zbatohen intervenimet në arkitekturën civile, në rast të ruajtjes, pastrimi dhe mirëmbajtja, restaurimi, rindërtimi, renovimi i fasadës. Llojet e propozuara të ndërtimit të ri dhe të shfrytëzimit të mbushjes po ashtu janë kontrolluar në titullin e vëllimit, në fasadë, detaje dhe dekorime, në propozimin e planit të qytetit dhe të rrugës.

### 2.5.7 PARKU NACIONAL “MALET E SHARRIT” – PLANI ZHVILLIMOR HAPËSINOR

Ashtu siç është përshkruar në PZHKP 2025, plani zhvillimor hapësinor për Parkun Nacional Malet e Sharrit rekomandon një veprim të organizuar dhe të bashkërenduar të të gjitha strukturave të përfshira, kërkon strategji dhe politika afatgjata të cilat do të bazohen në rezultatet e procesit të planifikimit dhe të hulumtimit. Në mënyrë që të merret me shfrytëzimin e pakontrolluar të vlerave natyrore dhe të degradimit mjedisor brenda kufijve të parkut nacional, plani propozon një kornizë prej gjashtë sfidave të cilat janë identifikuar me anë të analizës SWOT. Plani përcakton tri zona të mbrojtjes mjedisore dhe të zhvillimit ekonomik brenda kufijve të parkut nacional. Zona e parë është e përkufizuar si rezervat i caktuar natyror i cili theksohet të mos ketë ndonjë zhvillim ekonomik por të ketë vetëm shtigje për ecjen e vizitorëve. Në zonën e dytë është pritur zhvillim i kufizuar ekonomik në të cilin duhet të krijohet infrastruktura teknike vetëm për mundësinë e shfrytëzimit të transportit për skijim dhe për aktivitete të tjera turistike. Aktivitetet dhe zhvillimi ekonomik janë propozuar në zonën e tretë në kushtet dhe konceptin e qëndrueshmërisë. Këto aktivitete janë turizmi sportiv, si edhe turizmi veror dhe dimëror, turizmi shëndetësor, eko-turizmi, turizmi rural dhe kulturor, turizmi shkencor dhe hulumtues, turizmi i kongreseve, turizmi alpin dhe turizmi i çiklistëve, etj. Në kohën e përgatitjes së këtij VSM ishte duke u përgatitur plani për menaxhimin e Parkut Nacional.

### 2.5.8 RISHIKIMI I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR HIDROCENTRALIN E ZHURIT

Raporti i fizibilitetit (përfshirë përgatitjen e Vlerësimit Paraprak të Ndikimit Mjedisor dhe Vlerësimin Paraprak Shoqëror) është një vlerësim i projektit të Hidrocentralit të Zhurit dhe ndikimet e tij të mundshme në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike. Ashtu siç është pasqyruar në PZHKP 2025, hidrocentrali i Zhurit është një sistem që përbëhet nga dy hidrocentrale të llojit akumulim-diversion, hidrocentrali Zhuri I dhe hidrocentrali Zhuri II. Hidrocentrali gjendet në veriperëndim të qytetit të Prizrenit. Hidrocentrali Zhuri I gjendet afër fshatit Zhur dhe hidrocentrali Zhuri II gjendet në Drinin e Bardhë. Raporti përmbledhë efektet e mundshme të favorshme gjatë funksionimit të projektit si, më shumë rregull brenda zonës së projektit të planifikuar; sasi të mjaftueshme të ujit për ujitje; rritje të lagështisë së ajrit dhe rritje të reshjeve, që me sa duket ka më së shumti ndikim të favorshëm në rritjen e hapësirave malore dhe të produkteve malore. Nga aspekti sociologjik dhe demografik, me kusht që të merren masat mbrojtëse, projekti i planifikuar nuk do ta kërcënojë jetën dhe kushtet e punës të popullsisë vendase, nuk do ta inkurajojë imigrimin, do ta ndal imigrimin, nuk do ta kërcënojë jetën afariste ose t'i kontaminojë burimet natyrore të cilat janë të rëndësishme për të jetuar dhe për të punuar në atë zonë. Raporti po ashtu thotë që pas ndërtimit, në shfrytëzimin e ri të tokës mund të përfshihet po ashtu shfrytëzimit për qëllime turistike dhe të rekreacionit. Punësimi i përkohshëm ose i përhershëm i fuqisë punëtore gjatë zbatimit të projektit është një efekt tjetër i mundshëm i projektit.

### III. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRIZRENIT PZHKP 2025

Procedura aktuale e Vlerësimit Strategjik Mjedisor është duke u kryer në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i mundshëm mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit PZHKP 2025. Përgatitja e PZHK të Prizrenit ka filluar më 2008 dhe versioni përfundimtar është përgatitur në mars 2012.

Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025 (PZHKP/PZHK) është caktuar nga Komuna e Prizrenit që ta planifikojë të ardhmen e zonës për një periudhë 15 vjeçare. Plani i përfshin të gjithë kufijtë e Komunës së Prizrenit, që është përafërsisht 640km<sup>2</sup> dhe ka për qëllim të ofrojë një kornizë për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe hapësinor të Prizrenit.

PZHKP është përgatitur për Komunën e Prizrenit përmes partneritetit të Qendrës për Planifikim dhe Hulumtim Urban dhe Hapësinor të Universitetit Teknik të Stambollit, Studios Urban Design nga Kosova dhe të Plan&Art nga Turqia. Projekti ka filluar në tetor 2008 dhe është përfunduar në janar 2010 dhe është ndryshuar në pranverë 2012. Qëllimi i procesit PZHKP ishte të përgatiste një plan që i merr parasysh tendencat zhvillimore të të gjithë vendit dhe zhvillimet rurale dhe ato urbane, në aspekt të mjedisit natyror, shoqëror-ekonomik dhe të atij të ndërtimit.


Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025 ndahet në katër pjesë kryesore:

1. Profili i Zhvillimit Komunal dhe Analiza e Gjendjes
2. Vizioni, Parimet dhe Objektivat
3. Korniza e Zhvillimit Hapësinor Komunal
4. Strategjitë, veprimet dhe dispozitat e zbatimit.

Planifikohet që PZHKP të çojë tek zhvillimi strategjik i Komunës së Prizrenit, ta paraqes një qasje të integruar, të sigurojë pjesëmarrje dhe ta ndihmojë monitorimin dhe rishikimin. Në veçanti, ai do ta lidhë zhvillimin e mëtejshëm me planet e nivelit të lartë, zhvillimin ekonomik dhe strategjinë e mirëqenies për të ofruar një mjet që do të merret parasysh gjatë përpjekjeve për planifikim lokal, për të ofruar një menaxhim dhe bashkërendim të balancuar të shfrytëzimit të tokës, modele për zhvillimin e ardhshëm, për ta inkurajuar angazhimin e banorëve dhe të shfrytëzuesve vendas që ta përkufizojnë procesin e ndryshimit dhe të përfshihen në të, të ndikojë në vendin e bërjes së investimeve, ta lehtësojë shfrytëzimin e Sistemeve Informative Gjeografike në vendimmarrjen e bazuar në dëshmi dhe të ndihmojë në përcjelljen e ndikimit të planit. Me zbatimin PZHKP modelet e zhvillimit të ardhshëm do të menaxhohen në mënyrë të balancuar, ndërsa do të ruhet hapësirat e ndjeshme nga aspekti mjedisor dhe ekologjik si edhe pasuritë natyrore dhe kulturore. Për t'i zbatuar përparësitë konkurruese të qendrës urbane do të sigurohet një ekonomi e zhvilluar dhe e larmishme. PZHKP po ashtu do t'i respektojë dallimet shoqërore, kulturore, fetare dhe individuale duke ofruar mundësi dhe qasje të barabartë në shërbime për të gjithë.

Përveç pasqyrës shumë gjithëpërfshirëse dhe analizës së gjendjes aktuale në Prizren, ai ka një element strategjik me vizion, parime dhe objektiva prej të cilave rrjedhin dispozitat e zbatimit. Kjo e fundit ka një rezultat të një numri të projekteve për t'i arritur objektivat strategjike që duhet të zbatohen brenda 2-5 vjetëve të ardhshëm. Korniza për zhvillimin hapësinor propozon konceptin e zhvillimit policentrik si model themelor të zhvillimit për zonën e Prizrenit që përfshin një zhvillim hapësinor hierarkik, i cili pritet ta zvogëlojë presionin si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale..

Figura 2.5.8.1 Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit PZHKP 2025. Harta e Planit Zhvillimor, e përfunduar në pajtim me shqyrtimin e komenteve më 2012



Burimi: Komuna e Prizrenit, PZHKP2025

## IV. PËRSHKRIMI I MJEDISIT BAZIK

Burimi kryesor i të dhënave mjedisore për këtë VSM janë kapitujt përshkrues të PZHKP 2025, meqë ky i fundit përfshin një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe një analizë të gjendjes aktuale në Prizren. Meqë PZHKP 2025 ishte dokumenti i parë zhvillimor i atij lloji, shumë informata dhe të dhëna të rëndësishme u mblodhën dhe u morën gjatë procesit të hartimit të PZHK. Të dhënat kryesore për materialin në vijim janë marrë drejtpërdrejt nga departamentet përkatëse të ministrive të Qeverisë së Kosovës. Të dhënat sekondare janë mbledhur nga studimet në terren që u kryen në mars dhe prill 2009. Të gjitha të dhënat e grumbulluara janë zbatuar në hartat digjitale duke i shfrytëzuar Sistemet Informative Gjeografike (SIGJ). Për përshkrimin e mjedisit bazik për raportin VSM të dhënat më të rëndësishme nga PZHKP mblidhen dhe kombinohen me informatat nga burimet e tjera të të dhënave (planet, programet, intervistat) të cilat shfrytëzohen gjatë procesit VSM.

### 4.1 PASQYRA E PËRGJITHSHME

Prizreni është komuna e dytë më e madhe e Kosovës pas Prishtinës. Është një qytet i lashtë historik përgjatë lumit Lumbardhë dhe shtrihet nën Malet e Sharrit. Ai ndanë kufijtë me Shqipërinë në perëndim, me komunën e Dragashit në jug, me IRJ të Maqedonisë në juglindje, me komunën e Shtërpçës në lindje, me komunën e Suharekës në verilindje, me komunën e Rahovecit në veri dhe me komunën e Gjakovës në veriperëndim.

Figura 2.5.8.1Vendndodhja e Komunës së Prizrenit në Kosovë



Komuna e Prizrenit përbëhet nga 75 fshatra sipas Statusit Komunal të Prizrenit. Tetë prej këtyre fshatrave janë drejtpërdrejt në territorin e qytetit të Prizrenit. Sipas regjistrimit të janë 10 fshatra kryesore: ato janë Gjonaj, Hoça e Qytetit, Lubizhda, Mushnikova, Pirana, Reçani, Romaja, Velezha, Zhuri, Zymi. Fshatrat kryesore kanë strukturë të njëjtë administrative si edhe fshatrat e tjera.

## 4.2 TOPOGRAFIA

Topografia e Komunës së Prizrenit ka strukturë të valëzuar kështu që lartësia ka një shtrirje ndërmjet 300 m – 2600 m. Ndërsa qendra e qytetit është e vendosur në hapësirë të rrafshët, topografia kodrinore vërehet në drejtim të anës perëndimore por në mënyrë më të qartë vërehet kah ana jugore. Vendndodhja gjeografike e Prizrenit ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, rritjen e kafshëve, industrinë e ushqimit dhe turizëm. Pjesët malore mbi 1500 m mbulojnë përafërsisht 15% të të gjithë kufijve komunal. Fusha e Prizrenit është një sipërfaqe e gjerë e rrafshët me një pjerrësi ndërmjet 0-5%. Ajo mbulon rreth 14000 ha që përbën përafërsisht 22% të hapësirës së Komunës së Prizrenit.

## 4.3 BURIMET E UJIT

Prizreni është njëri prej vendeve fatlume sa i përket sasisë së burimeve të ujit. Lumi më i rëndësishëm dhe më i gjatë në Prizren është Drini i Bardhë (111 km). Ai hyn në Prizren nga veriu dhe vazhdon drejt jugperëndimit në Shqipëri në Detin Adriatik. Lumi formon një liq të vogël brenda kufijve të fshatit Dobrushë. Lumi i quajtur Lumbardhë me gjatësi prej 35 km rrjedhë nëpër Luginën e Zhupës dhe vazhdon përmes qendrës së qytetit të Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm në Prizren është Lumi Toplluha i cili është 37 km i gjatë. Hedhja e mbeturinave organike dhe e ujërave të kanalizimit drejt në lumenj shkakton ndotje të ujit në Komunën e Prizrenit. Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Lumi Drini i Bardhë në Komunën e Prizrenit është i treti me prioritet të tretë brenda vendit për zvogëlimin e ndotjes së ujit. Për shkak të faktit që nuk mblidhen të dhënat e rregullta për cilësinë e ujit dhe nuk ka pasur në dispozicion të dhëna cilësore publike nuk dihet gjendja e saktë mjedisore e burimeve të ujit dhe ndikimi i ndotjes.

## 4.4 BURIMET MINERALE

Ndërtimi gjeologjik dhe tektonik i Komunës së Prizrenit është treguesi kryesor i pritjeve për paraqitjen e burimeve të mineraleve. Ky territor njihet se ka qenë burim i mineraleve të dobishme në të kaluarën. Ekzistojnë burime të mineraleve metalike siç është kromi, hekuri, bakri dhe piriti. Mineralet jo-metalike janë të dukshme në të gjitha formimet gjeologjike në krahasim me mineralet metalike. Mermeri i Zhurit, Gjonajve dhe zonave afër kufirit me Maqedoninë janë të lidhura me formimet Paleozoike. Sedimentet e Mesozoikut (Triasiku i vonë dhe i mesëm) kanë veçori të mira dhe tipare teknike të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe të gurëve për ndërtim në përgjithësi. Sedimentet e katërsorit janë lymoret dhe brezaret e lumenjve, materialet e thyera, etj. Rëra dhe zhavorri gjenden në Piranë (2.000.000 m<sup>3</sup>) dhe në Krushë të Madhe (2.000.000 m<sup>3</sup>). Argjila gjendet në Landovicë (2.598.072 m<sup>3</sup>). Burimet e mineraleve jo-metalike siç është rëra; zhavorri, argjila, etj. kryesisht gjenden në kodra. Mineralet e tjera siç janë gëlqerja, shisti i kristalizuar, gurët për ndërtim dhe shisti talk gjenden në pjesët malore. Kjo zonë gjendet në një rajon të pazhvilluar dhe qasja në të është e vështirë.

## 4.5 GJEOLGJIA DHE HIDRO-GJEOLGJIA

Në aspektin hidro-gjeologjik, shkëmbinjtë e Komunës së Prizrenit mund të ndahen në:

- Shkëmbinj me porozitet të ndër-kokërrzuar
- Shkëmbinj me thyerje dhe fenomene gëlqerore
- Shkëmbinj izolues

Në shkëmbinjtë me porozitet të ndër-kokërrzuar bëjnë pjesë të gjitha rezervat e Pliokenit dhe të Katërsorit. Sedimentet e tilla vërehen më lehtë në lindje të lumit Drini i Bardhë ose në jug të luginës së Dukagjinit. Ato krijohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Të gjitha ato gjenden në majë të sedimenteve me shkumës. Sedimentet e Katërsorit – përfaqësohen nga sedimentet e liqenit dhe sedimentet e brezareve të lumenjve të Pleistocenit dhe nga rezervat proluviale Terra Rosa dhe lymoret Holocene. Këto sedimente janë të shpërndara në gjatësi dhe njihen si mbledhëse të ujërave nëntokësore. Këto sedimente përfaqësohen nga argjilat ranore dhe të zhavorrit me ngjyrë të verdhë dhe bojëkafe, etj. Terrenet e maleve të larta të formuar kryesisht nga gurët gëlqeror njihen për zhvillimin e fenomenit gëlqeror në sipërfaqe dhe brenda tyre. Këto terrene posedojnë rezerva të ujërave nëntokësore të cilësisë së lartë. Atje ekzistojnë po ashtu edhe shumë burime me kapacitet të lartë.

Planifikimi i studimeve hidro-gjeologjike është i lidhur ngushtë me planifikimin hidro-gjeologjik për tërë Kosovën. Zhvillimi i vendbanimeve urbane varet nga furnizimi me ujë. Bujqësia bashkëkohore ndërtohet në premisa të ujitjes. Hulumtimet e kryera kanë treguar që Komuna e Prizrenit është e pasur me ujëra nëntokësore që mund të shfrytëzohen për qëllime të ujit të pijshëm, ujit për industri dhe ujitje. Për këto arsye PZHKP 2025 thekson nevojën për hulumtime

të mëtejshme hidro-gjeologjike. PZHK po ashtu thekson nevojën jetike për hulumtime të mëtejshme gjeologjike me që njohuria gjeologjike e mjedisit është me rëndësi vendimtare për planifikimin hapësinor dhe në përgjithësi për nevoja të ndryshme të shfrytëzimit të tokës. Hulumtimet e inxhinierisë gjeologjike janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishme kur është fjala për planifikimin hapësinor në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli i mbarë Kosovës, niveli komunal, zonat e interesit të posaçëm turistik, plani urban i vendbanimeve dhe objektet e interesit kapital. Jo stabiliteti i vendit po ashtu manifestohet me rrëshqitje, përplasje, erozion, etj. Rrëshqitja ndodhë në terrenet jo-shkëmbore. Përplasjet ndodhin në terrenet shkëmbore, kryesisht të formuara nga metamorfozat gjarpërore dhe gëlqerja. Erozioni linear paraqitet në burime dhe në lumenj dhe duket në tërë komunën, kryesisht në pjesët malore ku nuk ka vegetacion ose në pjesët ku pyjet janë të dëmtuara.

#### 4.6 KUSHTET KLIMATIKE

Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të butë të klimës mesdhetare në lartësitë më të ulëta, ndërsa klima e ashpër alpine mbizotëron në male. Karakteristikat e buta klimatike krijojnë favor të mirë për burimet e pasura natyrore. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit, si edhe të pemëve dhe të perimeve tjera. Largësia nga deti është një tregues i rëndësishëm i kushteve klimatike dhe Prizreni është 105 km larg nga deti. Temperatura mesatare më e lartë në vjeshtë është 17.6°C. Në 60% të vitit temperatura është më e lartë se 0°C që do të thotë se gjatë 229 ditëve nuk ka ngrica. Sa ju përket të reshurave, mesatarja vjetore është 686 mm në Prizren, duke krijuar kështu kushte ideale për vreshtari sa i përket sasisë së reshjeve. Në Prizren, sasia e reshjeve është me lartë në dimër dhe prandaj shpërndarja e reshjeve të shiut është po ashtu e përshtatshme për vreshtari.

#### 4.7 VLERAT NATYRORE

Në Prizren, ekzistojnë tri rezerva natyrore si, Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e Madhe të cilat janë të rëndësishme me rezervat e tyre të bimëve të species endemike-relikte Pisha e Bosnjës (*Pinus Heldreichii*). Sipërfaqja më e madhe e hapësirave të mbrojtura është Parku Nacional “Malet e Sharrit” që gjendet në Komunën e Prizrenit. Malet e Sharrit gjenden në rajonin e Kosovës dhe të Maqedonisë dhe përfshijnë 1600 km<sup>2</sup>. Pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon territorit të Kosovës dhe përfshin një hapësirë prej 1100 km<sup>2</sup>. Më 1986 Kuvendi i Kosovës ja dha Malit të Sharrit statusin e vendit të trashëgimisë së regjistruar natyrore në klasifikimin e Parkut Natyror. I përkufizuar nga rregulloret juridike dhe plotësimi i kushteve, i përkufizuar nga rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, parku nacional kishte një plan zhvillimor hapësinor i cili është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.

#### 4.8 MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS

Hapësira e plotë e Komunës së Prizrenit është 63,780.67 ha e cila e bën atë komunën më të madhe të Kosovës. Ajo mbulon përafërsisht 5.94% të krejt territorit të Kosovës (Profili Komunal i Prizrenit, 2007). Mënyra e shfrytëzimit të tokës tregon që mbizotëron karakteri rural. Hapësirat e banueshme janë 3,392.72 ha duke përbërë vetëm 5.3% të krejt hapësirës komunale. Hapësirat bujqësore dhe pyjet mbulojnë 90.05% të kufijve komunalë me një hapësirë të plotë prej 57,434.1 ha. Pyjet në Prizren mbulojnë përafërsisht 8,500 ha përfshirë hapësirat pyjore me intensitet të lartë dhe të ulët të cilat janë vetëm 13% e kufijve komunalë.

Tabela 2.5.8.1 Proporcioni i shfrytëzimit të tokës në Prizren

Lloji i shfrytëzimit të tokës	Hapësira/hektarë
Bujqësore	57434
Shtëpi/Vendbanime	2500
Të tjera	1960
Infrastruktura/Të pa kategorizuara	1105
Tregtare/Shërbyese/Shfrytëzim i përzier	340
Industrial	179
Objekte urbane	164
Ushtarake	95


Burim: Ministria e Bujqësisë, 2005; Studim në terren, 2009

#### 4.9 MENAXHIMI I UJËRAVE DHE I KANALIZIMIT

Hapësira e përgjithshme e mbuluar me sistemin e furnizimit me ujë është 13.5 km<sup>2</sup> dhe konsumimi mesatar i ujit për kokë banori në ditë është 150 L. Pjesa më e madhe e rrjetit ekzistues është më e vjetër se 40 vjet dhe është duke u punuar vazhdimisht për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimit dhe të ujësjellësit. Edhe pse burimet e ujit të komunës janë të pasura dhe të përshtatshme me shkrirjen e borës sidomos në pranverë, sasia e ujit ulët gjatë verës dhe vjeshtës. 60% e komunës është e vendosur në pjesë të ulëta ku furnizimi me ujë bazohet në gravitacion. 40% e hapësirave duhet të furnizohen me ujë përmes pompave të ujit që është problematike për shkak të ndërprerjeve të energjisë elektrike. Sipas Profilit Komunal të Prizrenit të vitit 2007, rrjeti ekzistues i kanalizimit është 136,493 km dhe mbulon kryesisht hapësirat e populluara afër qytetit të Prizrenit. Shumë projekte janë zbatuar pas luftës sa i përket ndërtimit të sistemit të kanalizimit për të ndërtuar objekte të përshtatshme në mënyrë që të mbrohen lumenjtë nga ndotja. Por prapë se prapë njëri prej problemeve kryesore është që kanalizimi derdhet në lumenj dhe në disa pjesë drejtpërdrejt në sipërfaqe pa u pastruar.

Në kohën e përgatitjes së raportit aktual VSM kompania vendase për menaxhimin e ujit „Hidroregjioni Jugor“ ishte në fazën përgatitore të projektit të përtëritjes së objekteve për trajtimin e ujit/të kanalizimit. Sipas përfaqësuesve të kompanisë, projekti financohet nga banka gjermane KWF dhe ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë do të jetë e gatshme më 2013 dhe përbëhet nga restaurimi i tubave dhe ndërtimi i kolektorit kryesor (në bregun e djathtë të lumit). Një hap tjetër është ndërtimi i objektit për trajtim, me kapacitet për shërbimin e 50 000 banorëve, afati i fundit është viti 2016. Pjesa e tretë ka ambicie të sigurojë shërbim për trajtimin e kanalizimit për krejt hapësirën e qytetit të Prizrenit deri më 2036. Sipas të dhënave të PZHK dhe të dhënave të mbledhura gjatë proceseve VSM atje, burimet e ujit kanë potencial të madh por ekziston nevoja vitale për menaxhim të duhur të ujërave /kanalizimit.

Figura 2.5.8.1 Rrejt i ujësjellësit në Prizren (PZHKP 2025)




Burimi: Komuna e Prizrenit, PZHKP 2025

#### 4.10 MENAXHIMI I MBETURINAVE

Sipas PZHKP 2025 një kompani publike dhe gjashtë kompani private i menaxhojnë shërbimet për mbledhjen e mbeturinave. Menaxhimi i mbledhjes së mbeturinave nuk ka arritur kapacitet të kënaqshëm ende dhe nuk ka kapacitet për mbulimin e fshatrave përreth, prandaj shkaktohet ndotja e lumenjve. Deponia e vjetër për hedhjen e mbeturinave në fshatin Korishë është mbyllur më 2005 dhe vendi i ri për hedhjen e mbeturinave, i cili i mbulon nevojat rajonale, është në Landovicë. Brendësia e vendit për hedhjen e mbeturinave përfshin komunën e Suharekës, të Gjakovës, të Rahovecit si edhe komunën e Prizrenit. Ajo është projektuar për 500,000 banorë dhe ka kapacitet prej 2,500,000m<sup>3</sup>. Koha e planifikuar e shfrytëzimit të deponisë është 18-20 vjet. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti VSM, Departamenti i Shërbimeve Publike i Komunës së Prizrenit dhe Ekipi i Ekspertëve i JICA ishin duke e përgatitur Planin për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta për Prizrenin, sipas projektit të planit shkalla\*2 e mbledhjes së mbeturinave është 70.6% në tërë hapësirën, 78.9% në hapësirën urbane dhe 52.6% në hapësirën rurale. Në Prizren praktikisht nuk bëhet ndarja e mbeturinave në burim. 15.1% e mbeturinave të gjeneruara hedhen në mënyrë të paligjshme dhe 11.8% të tyre largohen nga Ekoregjioni (kompani vendase për menaxhimin e mbeturinave.) Shkalla aktuale e riciklimit është vetëm 5%. Duhet të përmendet që pjesa më e madhe e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta (menaxhimi i deponisë, zgjedhja e deponimë së re) menaxhohen në aspektin nacional, çdo zhvillim tjetër në lidhje me riorganizimet e mëdha në këtë fushë nuk do të mund të vendosej në nivel komunal.

Figura 2.5.8.1Ndarja e Menaxhimit të Mbeturinave në Prizren (sasia e mbeturinave në ditë)



#### 4.11 TRASHËGIMIA KULTURORE

Qyteti gjithmonë ka qenë udhëkryq i kulturave dhe i grupeve të ndryshme etnike dhe prandaj Prizreni pasqyron një histori të mrekullueshme të territorit të Kosovës. Ekzistojnë shumë ndërtesa të rëndësishme monumentale të trashëguara nga civilizime të ndryshme, posaçërisht nga epoka Otomane, kur qytetit fitoi rëndësi të madhe si qytet tregtar përparimtar duke ju falënderuar pozitës së tij strategjike. Ekzistojnë 291 monumente dhe lokacione kulturore në Komunën e Prizrenit, të cilat janë të regjistruara nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (2009). Qyteti i Prizrenit ka shumicën dhe llojllojshmërinë më të madhe të monumenteve dhe të lokacioneve që paraqesin sfondin historik të territorit të tij. Në Komunën e Prizrenit si klasifikim monument arkitektonik janë 50 ndërtesa publike të cilat janë në shfrytëzim dhe / ose pronësi të palëve publike ose shtetërore.

#### 4.12 DEMOGRAFIA DHE PUNËSIMI

Si në mbarë Kosovën, regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 janë të dhënat e fundit zyrtare lidhur me popullsinë në Prizren. Enti i Statistikës i Kosovës (ESK) më 1991 ka përcaktuar se në Prizren jetojnë 178,723 banorë. Sipas të dhënave të siguruar nga ESK, popullsia e Komunës së Prizrenit gjithmonë ka pasur ekuilibër ndërmjet të jetuarit në fshat dhe në qytet; përafërsisht 50% e numrit të përgjithshëm të popullsisë në komunë ka jetuar në viset rurale deri më 1991. Në kohën kur është përgatitur ky VSM të dhënat zyrtare nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 nuk kanë qenë në dispozicion ende. Studimi i fundit është kryer nga Zyra për Komunitete e Komunës së Prizrenit për vitin 2009 dhe numri i popullsisë së Prizrenit është llogaritur të jetë 240,000 banorë. Shkalla mesatare e rritjes së popullsisë në Prizren është llogaritur si 2.3% në vit për periudhën 1971-2009. Prizreni është njëra prej pesë komunave më të dendura në Kosovë me 375 persona për km<sup>2</sup> deri në vitin 2009. Sipas llogaritjes së PZHKP 2025, numri i popullsisë së Prizrenit është përafërsisht 150,000. Të dhënat lidhur me rajonet rurale janë paraqitur në Tabelën 1.

Tabela 2.5.8.1 Popullsia në rajonet e Prizrenit

Center/Region	2001*		2009**	
	Population	%	Population	%
PRIZREN	138,042	62.53	~150,000****	61.26
Prizren	7,190	3.26	7,880	3.28
Has	20,844	9.44	20,825	8.68
Kabash	7,000	3.17	10,412	4.34
Luma	12,140	5.50	14,210	5.92
Podrimi	14,019	6.35	18,600	7.75
Vrini	10,419	4.72	9,080	3.78
Zhupa	11,122	5.04	11,980	4.99
Total	220,776	100.00	~240,000***	100.00

*Burimi: Komuna e Prizrenit, PZHK Prizrenit 2025*

Studimi më i fundit në lidhje me grupmoshat në Kosovë është kryer nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara (FPKB) më 2003. Sipas këtij studimi, kategoria e fëmijëve në Kosovë (prej moshës 0-14 vjeç) përfaqëson 33% të popullsisë. Pjesëmarrja e popullsisë së moshës 15-64 vjeç është 61%. Popullsia e moshën mbi 65 vjeç përfshin 6% të popullsisë. Dominimi i popullsisë së re është tipar kryesor i Kosovës që është rezultat i shkallës së lartë të rritjes së popullsisë. Në Prizren, studimi më i fundit mbi grupmoshat është kryer sipas regjistrimit të vitit 1991 dhe rezultatet tregojnë që shpërndarja e popullsisë sipas grupmoshave ka karakteristika të ngjashme si Kosova. Megjithatë, banorët e Komunës së Prizrenit janë të moshës relativisht të re me 36.9% të grupmoshës 0-14 dhe vetëm 4.9% mbi moshën 65 vjeçare. Struktura etnike e Prizrenit përbëhet nga shqiptarët dhe boshnjakët. Rajoni i Prizrenit paraqet strukturën më të llojllojshme etnike. Fshatrat në lindje të qytetit të Prizrenit janë përgjithësisht boshnjake ndërsa ato në perëndim janë përgjithësisht shqiptare. Në lidhje me të tjerët, të gjitha rajonet përbëhen nga shumica shqiptare me përjashtim të Zhupës e cila është boshnjake. Sa ju përket pakicave etnike, në Komunën e Prizrenit jetojnë serbë, turq dhe romë.

Nëse merret parasysh madhësia e ekonomive shtëpiake në Prizren, ato paraqesin një mesatare të përgjithshme prej 6.87 në gjithë territorin rural të Prizrenit. Sa ju përket të dhënave të fundit të studimit në terren të PZHKP 2025, shpërndarja e ekonomive shtëpiake në mesin e rajoneve të Prizrenit tregon pjesën më të madhe në Has me 19.04% (2,377 ekonomi shtëpiake) dhe më të ulëtën në Prizren me 8.53% (1,065 ekonomi shtëpiake). Gjithsej në viset rurale të Prizrenit janë përafërsisht 12,500 ekonomi shtëpiake.

Sipas shifrave të përafërta të siguruar nga Qendra për Punësim (Profili Komunal i Prizrenit, 2007), në Prizren janë të punësuar 21,271 banorë; 20.40% (4,341) prej të cilëve janë në sektorin shoqëror dhe 22.50% (4,787) në atë publik. Diku 12,000 persona janë të angazhuar në biznesin e bujqësisë. Në Profilin Komunal të Prizrenit (2007) thuhet se numri i përgjithshëm i të punësuarve është shumë më i lartë nëse merren parasysh të punësuarit ditor ose sezonal që punojnë në ndërtimtari, si shitës në rrugë, si zejtar, etj. Kjo do të thotë që ekziston fenomeni i punësimit të paligjshëm dhe atij të përkohshëm.

#### 4.13 EKONOMIA

Në Prizren përafërsisht 40% e popullsisë jeton në viset rurale. Prandaj, sektori i bujqësisë mbetet njëri prej burimeve më të rëndësishme të punësimit dhe të të ardhurave. Aktivitetet bujqësore përfshijnë prodhimin e drithërave dhe perimeve. Komuna e Prizrenit ka rreth 14,096 ha kullosa të cilat formojnë një bazë për zhvillimin e prodhimeve të kafshëve.

Rajonet e Prizrenit kanë aktivitetet industrial në afërsinë e tyre përveç Hasit. Të gjitha rajonet e Prizrenit kanë industri të materialit ndërtimor në afërsi të tyre, përveç Hasit dhe Lumës. Luma ka vetëm industri të materialit të kanalizimit. Prizreni, Kabashi dhe Podrimi janë të pasur në shpërndarjen e aktiviteteve industriale ndërsa Hasi nuk ka aktivitetet industrial, dhe Luma, Vrini dhe Zhupa kanë disa. Industria e metalit të nikelit është e pranishme vetëm në rajonin e Prizrenit. Prodhimi i ushqimit është njëri prej aktiviteteve kryesore prodhuese në Prizren. Janë dy ndërmarrje të rëndësishme shoqërore dhe ato janë fabrika e ushqimit “Abi Elif” dhe “Euro Food”. Prizreni ka një traditë të gjatë të prodhimit të verërave. Fabrika për Përpunimin e Verës “Kosovo-Vera Company”, e cila gjendet në Krushë të Vogël, është themeluar më 1952 si kompani shoqërore. ‘Kosovo Vera’ ka kapacitet të përpunimit deri në 2,240 litra dhe dikur ka përpunuar 700-800 vagonë rrush në vit. Fabrika për Prodhimin e Produkteve Kimike dhe Farmaceutike “Farmakos” gjendet në Prizren, kapaciteti i përgjithshëm prodhues i fabrikës sot është 5.113 milionë euro. Më 2002, Farmakosi kishte qarkullim prej 500.000 eurosh, nga shitja e mallrave të tij në Kosovë dhe në Maqedoni. Prizreni është qyteti më i vizituar në Kosovë dhe ka potencial për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit. PZHKP dhe burimet e tjera të të dhënave nuk japin të dhëna specifike lidhur me indikatorët e turizmit ose për ndonjë plan të ardhshëm, por sidoqoftë rritja e shpejtë e këtij sektori ekonomik do të mund të mbikëqyrej gjatë periudhës përgatitore të VSM.

## V. AFATI KOHOR I VSM

Sipas legjislacionit nacional të Kosovës, VSM do të kryhet gjatë përgatitjes së planit ose të programit dhe para se ai të aprovohet. Për shkak të faktit që PZHK i Prizrenit ishte përgatitur (nuk ishte aprovuar plotësisht) para se Ligji për Vlerësimin Mjedisor Strategjik të hyjë në fuqi, ky parim nuk ka mundur të realizohet në tërësi brenda procesit aktual të VSM. Përgatitja e PZHK të Prizrenit ka filluar më 2008 dhe versioni përfundimtar është përgatitur në mars 2012. Procesi VSM ka filluar në maj 2012. Në qershor 2012 është realizuar një vizitë në terren gjatë së cilës janë zhvilluar shumë takime me aktorët lokalë në mënyrë që të mblidhen të dhëna shtesë për procesin VSM. Në shtator 2012 është realizuar një vizitë tjetër në terren ku janë mbajtur takime dhe punëtori shtesë me aktorët kryesorë të mjedisit për t'i diskutuar skenarët e propozuar dhe objektivat mjedisore, synimet dhe indikatorët nga faza themelore e përgatitjes së VSM. Vizita e tretë në terren në fillim të tetorit 2012 ka përfshirë prezantimin dhe diskutimin e draftit të raportit VSM. Pas ndryshimit përkatës, prej tetorit deri në nëntor 2012 janë kryer konsultime dhe publikime legjislative.

### 5.1 QASJA PJESËMARRËSE E PROCEDURËS VSM

Meqë procedura VSM duhet t'i përshtatej situatës ku PZHK i vlerësuar ishte përgatitur krejt para vlerësimit, veprimet pjesëmarrëse ishin të kufizuara deri në një masë. Sidoqoftë, qasja pjesëmarrëse u përfshi në procesin VSM përmes seancave tematike të trajnimit, punëtorive dhe intervistave të cilat u kryen gjatë misioneve të sipërpërmendura. Seancat e trajnimit (të kryera në qershor dhe në shtator) i kushtoheshin kryesisht personelit komunal dhe u mbajtën së bashku me përfaqësuesit nga komuna fqinje e Rahovecit. Qëllimi i seancës së trajnimit ishte (ri) familjarizimi i përfaqësuesve komunalë përgjegjës për VSM me qasjen pjesëmarrëse, teorinë dhe praktikën në pajtim me kërkesat dhe kushtet specifike nga VSM. Seancat e trajnimit përfshinin diskutime ndërvepruese ndërmjet pjesëmarrësve dhe ndarjen e përvojave ndërmjet dy komunave në mënyrë që të identifikohen mundësitë dhe/ose pengesat për përfshirje efektive të aktorëve në procedurat aktuale dhe të ardhshme të VSM. Përveç seancave trajnuese, në Prizren janë mbajtur dy punëtori gjysmë publike (përveç personelit komunal në punëtori u ftuan të marrin pjesë edhe aktorët e identifikuar paraprakisht) (lista e pjesëmarrësve është bashkëngjitur, shtojcat 1-2). E para është mbajtur më 14.09 në mënyrë që të prezantohen dhe të diskutohen elementet themelore të VSM – çështjet mjedisore kryesore, skenarët e identifikuar alternativë, objektivat, indikatorët dhe veprimet mjedisore. Një punëtori tjetër u mbajt më 4 tetor dhe përfshiu prezantimin e skenarëve alternativë dhe elementet e tyre kryesore. Përveç njoftimit të aktorëve kryesorë të rajonit në çështjet mjedisore me procesin e vazhdueshëm VSM dhe mbledhjen e të dhënave shtesë, shumë intervista/takime në

katër sy u mbajtën me përfaqësuesit e sektorit privat (kompanitë për menaxhimin e ujit & mbeturinave), publik (zyrtarë të ndryshëm komunalë, Parku Nacional Malet e Sharrit) dhe qytetar (OJQ për mjedisin, Trashëgimia Kulturore pa Kufij), në shënime përfshiheshin mendime dhe informata të vlefshme dhe ato i janë bashkëngjitur raportit aktual (Shtojcat 3-4).

## VI. FAZAT E VSM DHE METODOLOGJIA

### 6.1 SHOSHITJA

Shoshitja është proces për vendosjen nëse një plan ose program, përveç atyre për të cilët VSM është i obligueshëm, do të kishte efekte të rëndësishme mjedisore dhe kështu do të justifikonte VSM. Në pajtim me legjislacionin e Kosovës (Ligji i Kosovës për Vlerësimin Mjedisor Strategjik, Ligji nr. 03/L-230) kryerja e VSM është kusht për planet zhvillimore komunale, prandaj për këtë VSM nuk është nevojitur kurrfarë procesi i posaçëm i shoshitjes.

### 6.2 KRIJIMI I FUSHËVEPRIMIT

Krijimi i fushëveprimit është procedura përmes së cilës vendoset shkalla e çështjeve mjedisore dhe niveli i hollësive që duhet të përfshihen në Raportin VSM. Krijimi i fushëveprimit ndihmon që VSM të përqendrohet në çështjet e rëndësishme siç janë ato që kanë të bëjnë me çështjet dhe problemet mjedisore ekzistuese dhe të mundshme, prandaj zvogëlon humbjen kot të burimeve në mbledhje të panevojshme të të dhënave. Krijimi i fushëveprimit lehtëson zgjedhjen e çështjeve që janë të rëndësishme për elementet mjedisore të cilat janë të saktësuara në Direktivën dhe legjislacionin VSM, domethënë; biodiversiteti, flora dhe fauna, popullsia dhe shëndeti njerëzor, toka, uji, ajri dhe faktorët klimatikë, pasuritë materiale, trashëgimia kulturore përfshirë trashëgiminë arkitektonike dhe arkeologjike dhe peizazhi.

Përgatitja e raportit të posaçëm të krijimit të fushëveprimit nuk është kërkesë formale e Direktivës VSM dhe legjislacionit nacional të Kosovës por rekomandohet si praktikë e mirë. Raporti për krijimin e fushëveprimit duhet të nxirret herët gjatë procesit të planifikimit të vlerësuar të dokumentit, për shembull së bashku me dokumentin e parë të konsultimeve për planin. Ky proces VSM është kryer në rrethana unike ndërsa plani/programi (PZHK i Prizrenit) ishte plotësisht i përgatitur kur filloi procesi VSM. Prandaj procesi i krijimit të fushëveprimit është përfshirë në përgatitjen e raportit VSM, elementet kryesore të procesit të krijimit të fushëveprimit janë diskutuar me aktorët lokalë dhe nuk është përgatitur raport i posaçëm i krijimit të fushëveprimit.

Faza e krijimit të fushëveprimit të VSM thekson një mori çështjesh të cilat janë shqetësuese dhe me rëndësi vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm në zonën e Prizrenit, domethënë

- Cilësia e Ujërave Nëntokësore & Cilësia e Ujërave Sipërfaqësore
- Menaxhimi i mbeturinave të ngurta
- Trajtimi i ujërave të zeza;
- Modelet e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës

Cilësia e Ujërave Nëntokësore dhe Cilësia e Ujërave Sipërfaqësore

Burimet nëntokësore të ujit janë pasuri e çmuar dhe e ndjeshme ndaj ndotjes me pasoja afatshkurta dhe afatgjata, me efekte të mundshme grumbulluese, etj. Burimet nëntokësore të ujit janë burim i paçmueshëm i furnizimit me ujë për opinionin, industrinë dhe bujqësinë dhe po ashtu luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e rrjedhjeve bazë në lumenj dhe në kontribuuesit e tyre brenda zonës së Prizrenit. Prandaj mbrojtja e tyre ka rëndësi të madhe. Ngjashëm me burimet e ujërave nëntokësore, burimet sipërfaqësore të ujit janë pasuri e rëndësishme për zonën e Prizrenit. Është me rëndësi të nënvizohet që çështja e ndotjes së lumenjve duhet të adresohet në mënyrë të duhur urgjentisht.

### Trajtimi i ujërave të zeza

Trajtimi i ujërave të zeza në zonën e Prizrenit është shqetësues duke qenë se PZHK thekson që një sasi e konsiderueshme e kanalizimit derdhet në lumenj dhe në disa pjesë drejtpërdrejt në vend të hapur pa u pastruar. Infrastruktura e kanalizimit dhe e ujësjellësit është e vjetër (tubat) ose mungon (objektet për trajtimin e kanalizimit). Ende ekzistojnë disa vende pa sistem të duhur publik të kanalizimit. Megjithatë, janë duke u bërë disa përmirësime. Kompania lokale e ujësjellësit është duke planifikuar përmirësim të sistemit dhe është duke u përgatitur instalimi i disa elementeve të infrastrukturës përkatëse.

### Menaxhimi i mbeturinave të ngurta

Zona e Prizrenit përballet me një gjendje ku numri i pamjaftueshëm i ekonomive shtëpiake (-70 %) përfshihet në sistemin e mbledhjes së mbeturinave të ngurta. Prandaj një sasi e konsiderueshme e mbeturinave kryesisht shtëpiake hidhet në mënyrë të paligjshme. Përveç sfidës për krijimin e një sistemi efektiv të mbledhjes së mbeturinave, ekziston nevoja për sigurimin e mënyrave bashkëkohore për trajtimin e mbeturinave të mbledhura. Momentalisht mundësia e vetme është hedhja e mbeturinave të mbledhura në deponinë në Landovicë.

### Modelet e shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës

E kaluara e komplikuar historike dhe periudha e gjatë kohore pa aktivitete të duhura strategjike dhe hapësinore kanë shkaktuar paraqitjen tepër të rrallë të zhvillimeve (zgjerimi i vendbanimeve, industrinë e reja, etj.). Një ekuilibër i duhur ndërmjet zonave kryesore të shfrytëzimit të tokës është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të Prizrenit. Ekziston nevoja për drejtimin e zonave ekonomike në atë mënyrë që të mos i kërcënojnë hapësirat e vlefshme bujqësore dhe natyrore. Meqë qyteti i Prizrenit shërben si qendër atraktive urbane, duhet t'i ketë masat e përshtatshme për zvogëlimin e ndikimit të mundshëm negativ të urbanizimit të shpejtë dhe të degradimit të tokës në zonat rurale. Duhet të gjendet një rrjet i përshtatshëm i vendbanimeve dhe i strukturës me shërbimin e nevojshëm publik.

### Shqyrtimi i alternativave

Në nenin 5 të Direktivës VSM saktësohet që Raporti Mjedisor duhet t'i marrë parasysh 'alternativat e arsyeshme që marrin parasysh objektivat dhe fushëveprimin gjeografik të planit ose të programit'. Çështja e alternativave është funksion kritik i procesit VSM dhe është i domosdoshëm për vlerësimin e pasojave të mundshme mjedisore të një vargu të strategjive alternative të zhvillimit për sferën e PZHK brenda kufijve të imponuar nga kushtet mjedisore.

Për VSM të PZHK janë analizuar tre skenarët e përmendur në vijim:

skenari 0 /skenari i të mos bërit asgjë. Ndikimet shoqërore-ekonomike dhe ato mjedisore do të analizohen në kontekst të moszbatimit të PZHK, aspektet pozitive dhe negative të gjendjes aktuale të mjedisit do të përshkruhen dhe do të analizohen, në të ardhmen duhet të parashikohen zhvillimet e mundshme të tendencave pa ndërhyrje. Edhe pse shfrytëzimi i skenarit të mos bërit asgjë nuk është alternativë e arsyeshme nëse përgatitja e PZHK kërkohet me ligj, por skenari i të mos bërit asgjë duhet të konsiderohet si standard me anë të së cilit vlerësohet PZHK i propozuar.

skenari i zbatimit të plotë të PZHK. Vetë PZHK i Prizrenit nuk përfshin skenarë zhvillimorë alternativë (konceptet alternative të zhvillimit hapësinor përmenden shkurtimisht në kuadër të kornizës së zhvillimit hapësinor), prandaj ndikimet kryesore të zbatimit të plotë të kornizës së zhvillimit hapësinor të PZHK të Prizrenit (qasja hapësinore policentrike), strategjitë e zbatimit, veprimet dhe dispozitat do të konsiderohen si njëri nga skenarët

skenari i ndarjes së integruar funksional të zonave. Meqë PZHK i Prizrenit aktualisht nuk përfshin elementin e ndarjes së integruar funksionale të zonave, është përshkruar dhe është vlerësuar skenari përkatës. Ndërsa koncepti i propozuar hapësinor policentrik kombinohet me elementet e konceptit zhvillimor kompakt dhe me një komponent strategjik të gjenerimit të qendrës rajonale

Përveç përshkrimit dhe analizimit të skenarëve të sipërpërmendur, është një detyrë që ka të bëjë me identifikimin e alternativës së parapëlqyer dhe përshkruan në mënyrë të saktë bazën e përshtatshme për këtë zgjidhje.

## 6.2 OBJEKTIVAT, QËLLIMET DHE INDIKATORËT

VSM shfrytëzon një kombinim të objektivave, të qëllimeve dhe të indikatorëve për të parashikuar ndikimet dhe për ta përshkruar dhe mbikëqyrur ndryshimin e planeve dhe programeve të propozuara për mjedisin. Objektivat Strategjike Mjedisore (OSM) dhe qëllimet caktojnë synimet dhe pragjet që duhet të merren parasysh kur të bëhet vlerësimi i ndikimit të planeve dhe programeve të propozuara për mjedisin. Të bashkuar me zhvillimin e OSM-ve janë indikatorët dhe qëllimet mjedisore. Indikatorët lehtësojnë aspektin mbikëqyrës të VSM, ndërsa qëllimet ofrojnë një objektiv real dhe të arritshëm në drejtim të të cilit mund të punojnë autoritetet lokale. Indikatorët shfrytëzohen për ta pasqyruar dhe komunikuar ndikimin në mënyrë të thjeshtë dhe efektive. Indikatorët po ashtu mund të shfrytëzohen për formimin e bazës së programit monitorues për PZHK.

**Objektivat mjedisore** ofrojnë një “synim” të standardit me anë të të cilit mund të testohen ndikimet mjedisore. Ato janë shpesh të ngjashme me masat që gjenden në PZHK ose rrjedhin nga objektivat që mund të ekzistojnë. Shembujt e objektivave mjedisore: zvogëlimi i zhurmës dhe i dridhjes në vendbanime, rritja e cilësisë së ujit në ujërat sipërfaqësore, zvogëlimi i emetimit të CO<sub>2</sub> nga transporti dhe prodhimi i energjisë elektrike, zvogëlimi i ndikimit në habitatet e caktuara.

**Indikatorët** ofrojnë mënyra për matjen e përparimit drejt arritjes së objektivit mjedisor me kalimin e kohës siç janë ankesat lidhur me zhurmën që pranohen gjatë një periudhe të caktuar të kohës, cilësia e ujit të lumit/liqenit, tonët e CO<sub>2</sub> që emetohen në vit, zona e habitateve të caktuara.

**Qëllimet** përshkruajnë gjendjen e dëshirueshme në lidhje me secilin objektiv në aspekt të përcaktimit të sasisë si vijon: zvogëlim për 50% i ankesave për zhurmë, arritja e qëllimeve që kërkohen nga rregulloret e fosforit, X ton të CO<sub>2</sub> të emetuar në vit deri në vitin 2020 ose kurrfarë ndikimi i rëndësishëm në popullatën e specieve të mbrojtura. Është e rëndësishme që indikatorët të jenë të matshëm dhe qëllimet të jenë reale dhe të sigurohet ose ekzistimi i rrjeteve monitoruese për matjen e indikatorit ose disponueshmëria e burimeve për krijimin e rrjeteve të reja monitoruese. Qëllimet dhe indikatorët sasior janë më të dobishëm se sa ata cilësor meqë ata mund të prodhojnë të dhëna të prekshme, të vërteta dhe, përderisa ato janë reale, është më lehtë që të monitorohen. Sidoqoftë, indikatorët cilësorë nuk duhet të lihen anash meqë nganjëherë ata janë opsioni i vetëm në dispozicion për matjen e përmbushjes.

Objektiv i raportit VSM është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të kontribuojë në integrimin e faktorëve mjedisorë në aprovimin dhe zbatimin e PZHK të Prizrenit.

Tabela 2.5.8.1 Objektivat e propozuara:

Objektivi	Indikatori	Qëllimi
<b>I Biodiversiteti, peizazhi dhe shfrytëzimi i tokës</b>		
Mbrojtja, konservimi dhe shmangia e humbjeve të llojllojshmërisë dhe të shtrirjes së habitateve, specieve dhe korridoreve të kafshëve të egra.	Rritja % e zonave të mbrojtura	15%
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve duke u bazuar në mjedisin e cilësisë së lartë për banim, të komunitetit, për punë dhe për rekreacion të bazuar në modelet e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës.	Indikatori cilësor	-
Mbrojtja e cilësisë së jetës së njerëzve duke iu shmangur rreziqeve ose telasheve (pluhurit, zhurmës, erës) që dalin nga ekspozimi ndaj shfrytëzimeve/zhvillimeve të papajtuësme të tokës (rëra /nxjerrja e gurëve për zhavorr)	Përqindja e zhvillimeve të eliminuara me rreziqet e mundshme ndaj cilësisë së jetës	30%
Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore përfshirë mjedisin dhe ambientet e ndërтуara; arkeologjike, arkitektonike dhe tiparet e peizazhit të krijuara nga njeriu.	Përqindja e rritur e vendeve të mbrojtura/të ruajtura të trashëgimisë natyrore	20%
Mbrojtja e peizazheve dhe pamjeve piktoreske të caktuara, rrugëve dhe tipareve të peizazhit me vlerë lokale	Një shumë e tipareve të mbrojtura të peizazhit	75
Sigurimi i hapësirave të gjelbëruara për kënaqësi	Një përqindje (nga hapësira e plotë) e hapësirave të gjelbëruara të siguruara.	20%
Mbrojtja, përmirësimi dhe mbajtja e cilësisë së tokës	Përmirësimi % i indikatorëve kimikë, fizikë dhe biologjikë të cilësisë së tokës	50%
<b>II Menaxhimi i mbeturinave të ngurta</b>		
Zgjerimi i sistemit të mbledhjes së mbeturinave të ngurta, përkrahja e opsioneve për trajtimin e qëndrueshëm të mbeturinave (ndarja, përzierja)	Përqindja e mbledhur nga sistemi mbledhës	80%
Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohet në deponi nga vendndodhja	% e zvogëlimit të mbeturinave të hedhura në deponi dhe mbeturinat e rishfrytëzuara	20%
Identifikimi i gurëthyesve të parregulluar, vendeve të deponive ose vendeve historike të ndotura në zonën e Prizrenit	% e vendeve	95%
Eliminimi i vendeve për hedhjen e mbeturinave	% e vendeve	80%
<b>III Mbrojtja e ujit</b>		
Mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së ekosistemeve ujore dhe, në lidhje me nevojat e tyre për ujë, të ekosistemeve tokësore dhe kënetave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemit ujor (cilësia, niveli, rrjedha).	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit (përmirësimi %)	50%
Zvogëlimi i ndikimit të substancave ndotëse për të gjitha ujërat	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit (përmirësimi %)	50%
Parandalimi i ndotjes dhe infektimit të ujit tokësor	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit (përmirësimi %)	50%
Mbajtja dhe përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit (përmirësimi %)	80%
Përkrahja e mbrojtjes afatgjatë të burimeve të disponueshme të ujit përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit.	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit (përmirësimi %)	50%

	%)	
Përmirësimi i infrastrukturës për t'i plotësuar nevojat e ardhshme të furnizimit me ujë dhe standardet për pastrimin e ujërave të zeza	Indikatori cilësor	
<b>IV Ndryshimi i klimës dhe efikasiteti i energjisë</b>		
Zvogëlimi i të gjitha formave të ndotjes së ajrit dhe mbajtja/përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit.	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit (përmirësimi %)	70%
Zvogëlimi i emetimeve të gazrave të serrës dhe kontribuimi në zvogëlimin dhe shmangien e ndryshimit të klimës të shkaktuar nga njeriu.	Emetimi i CO2	20%
Shtimi i mënyrave të qëndrueshme të transportit dhe sigurimi i lehtësisë së lëvizjes për të gjithë shfrytëzuesit e rrugës dhe përkrahja e modeleve të zhvillimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e sigurisë në rrugë.	Numri i automjeteve hibride/me rrymë elektrike, sasia e (km) e lehtësive të transportit të lehtë	50 vetura/20 km
Zvogëlimi i humbjes së energjisë, përkrahja e shfrytëzimit të burimeve të energjisë së përtëritshme dhe përkrahja e nismave për ruajtjen e energjisë. Përkrahja e ruajtjes së energjisë në të gjithë sektorët. Përkrahja e zhvillimit të tregtisë dhe ndërtesave me karbon të ulët	Indikatori cilësor	
Zvogëlimi i rrezikut nga vërshimet dhe i lëndimit të njerëzve, dëmeve në pronë dhe në mjedis	Numri i projekteve/aktivitetet të ndërmarra për ta zvogëluar/shmangur rrezikun nga vërshimi	10 në vit

## VII. VLERËSIMI MJEDISOR I PZHK

Në përgjithësi, intensifikimi i zonave aktuale industriale dhe ndreqja e zonave të dikurshme industriale kanë ndikim pozitiv për kushtet mjedisore dhe shoqëro-ekonomike të mjedisit. Ka mundësi që intensifikimi i hapësirave aktuale industriale është më i qëndrueshëm se sa krijimi i të rejave, meqë tashmë ekziston struktura e përshtatshme. Kjo po ashtu mundëson mbledhjen e ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe prandaj shtrirja e mjedisit që është nën ndikim do të jetë në mënyrë domethënëse më e vogël se sa në rast të disa zonave të ndryshme industriale. Ngjeshja e zonave industriale vërtetë shton ndikimet negative mjedisore në hapësirë, por në anën tjetër një pjesë më e vogël e hapësirës natyrore të paprekur deri më tani do të ndikohet.

Zonat industriale dhe afariste të planifikuara dhe të përcaktuara mirë ndihmojnë në ruajtjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të komunës meqë krijojnë parakushte për rritjen dhe zgjerimin e ekonomisë lokale, mund të tërheqin investime jashtë Prizrenit/Kosovës, po ashtu ndihmojnë në krijimin e vendeve të punës dhe uljen e shkallës së papunësisë.

Megjithatë, nëse objektet e planifikuara industriale vlerësohet se krijojnë burim shtesë të ndotjes jo në atë vend, sidomos për ujin, nevojitet krijimi i mjeteve dhe i masave të përshtatshme (mbledhje të duhur të ujërave të zeza/të mbeturinave dhe objekte për trajtim, sisteme për filtrimin e ajrit, etj.) në pajtim me objekteve industriale të planifikuara me kujdes.

Nëse do të caktohen vende të reja banimi, është me rëndësi të kihet parasysh që këto vende të vendosen në atë mënyrë që të garantohet cilësia e lartë e jetesës për banorët e mundshëm dhe në anën tjetër që ndikimet e mundshme negative të vendosjes së vendbanimit të ri në mjedisin natyror të jetë sa më i vogël që është e mundshme. Një planifikimi i duhur i infrastrukturës së përshtatshme (menaxhimi i ujërave/ujërave të zeza, infrastruktura energjetike, kushtet për transport efektiv dhe të qëndrueshëm, etj.) për zonat e vendbanimeve të reja ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve të mundshme mjedisore.

Shfrytëzimi i minierave është aktivitet ekonomik i cili ndikon fuqishëm në burimet natyrore dhe në peizazh. Edhe pse nuk ka të dhëna adekuate lidhur me burimet minerale të Prizrenit sipas njohurive të tanishme në atë zonë ka burime të ndryshme minerale dhe mund të paraqitet interesimi për shfrytëzimin e minierave. PZHK nuk përcakton ndonjë vend të posaçëm të minierave, prandaj çdo synim për të kryer aktivitet të shfrytëzimit të mineraleve duhet të vlerësohet ndaras (VNM) për t'iu shmangur konflikteve me këtë PZHK (duke e pasur parasysh që përshkruhet se disa prej pasurive të vlefshme minerale siç është kromi, hekuri, bakri, ari, mercuri gjenden në pjesët malore të Maleve të Sharrit) dhe eksploatimit të tepërt të burimeve.

Në rastin e PZHP të Prizrenit, është me rëndësi të përmendet se niveli i qeverisjes lokale nuk ka mundur t'i trajtojë të gjitha çështjet thelbësore mjedisore. Çështjet komplekse të ndotjes së bazuar në burimet e vendit dhe jo të atij vendi kanë nevojë për aktivitete më të përgjithshme planifikuese nga autoritetet nacionale. Gjatë procesit VSM nuk ishte e mundur (pjesërisht për shkak të mungesës së të dhënave) që të identifikohen burimet e ndotjes nga vendi, mund vetëm të vlerësohet që deponia e Landovicës mund të shërbejë si burim i ndotjes për burimet e tokës dhe të ujit. Prapë se prapë, meqë deponia dhe sistemi i menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi planifikohet dhe menaxhohet nga autoritetet nacionale, nevojitet monitorim i duhur i ndikimit së bashku me sistemin efikas të menaxhimit qendror për t'u marrë me problemin në Prizren dhe gjetkë në Kosovë. Megjithatë, në mënyrë që banorët lokalë të kenë qasje më të lehtë dhe të jenë në gjendje ta paguajnë menaxhimin e mbeturinave (sidomos në viset rurale) autoritetet lokale mund të kontribuojnë në objektivin e zvogëlimit të sasisë së mbeturinave që depozitohet në deponi. Përveç dobive mjedisore, ndarja e mbeturinave në vend dhe riciklimi (krijimi i vendeve për transportimin/ndarjen e mbeturinave) përfshin dobi ekonomike siç është zvogëlimi i shpenzimeve për transportim/deponim, shfrytëzimi i mundshëm i materialeve të ricikluara përfshirë përzierjen.

Është e mundshme dhe e qartë që shkalla e lartë e ndotjes në burimet nëntokësore të ujit shkaktohet nga burimet e ndotjes të jashtme nga toka bujqësore dhe zonat e banueshme. Ky problem duhet po ashtu të adresohet në nivel nacional. Ekziston nevoja për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të burimeve të jashtme të ndotjes nga modelet adekuate të vlerësimit (të bazuara në SIGJ) meqë ndikimet ka shumë mundësi të jenë tej-kufitare. Edhe pse PZHK përfshin propozimin e projektit për hartimin e planit të Menaxhimit të Shtratit të Lumenjve në pajtim me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat nëse mbështetet nga veprimi dhe udhëheqja qendrore.

Përmes ruajtjes së modeleve të balancuara të shfrytëzimit të tokës me këtë PZHK dhe me dokumentet e tjera të planifikimit hapësinor është e mundur të shmangen dhe të zvogëlohen ndikimet e mundshme negative në mjedis. Hapësirat zhvillimore të planifikuara dhe të zbatuara mirë (si ato të banimit po ashtu edhe ato industriale) ndihmojnë zvogëlimin e humbjes së biodiversitetit dhe mbrojtjen e habitateve të vlefshme. Po ashtu ofrojnë mundësi për krijimin e infrastrukturës së nevojshme dhe vendosjen e sistemeve për parandalimin e ndotjes nga kanalizimi dhe mbeturinat.

Gjatë procesit të vlerësimit është marrë parasysh po ashtu edhe efekti i mundshëm kolektiv i ndikimeve. Ndikimi kolektiv paraqitet nëse ndikimet e vetme do të ndikojnë në mjedis në të njëjtën kohë dhe ky ndikim kolektiv nuk është domosdoshmërisht shuma aritmetike e ndikimeve të vetme.

Në rastin e PZHK të Prizrenit efekti pozitiv kolektiv ka më së shumti mundësi të paraqitet në fushat zhvillimore të dhëna në vijim:

- ndikimi në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve – ndikimi pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve shkaktohet nga krijimi i zonave të reja të banimit, zonave afariste dhe rekreative si edhe nga infrastruktura bashkëkohore teknike. Efekti kolektiv i atyre aktiviteteve është më i fuqishëm se efektet e ndara që mund të kenë aktivitetet e vetme;
- ndikimi në kushtin ekonomik – rezervimi dhe përcaktimi i zonave industriale dhe afariste krijon parakushte për ndërmarrje dhe vende të reja pune. Aktivitetet ekonomike do të zgjerohen, mirëqenia ekonomike do të rritet.;
- ndikimi në mjedisin natyror dhe bujqësor – rezervimi i vendbanimeve të reja dhe të zgjeruara dhe zonave industriale/afariste është duke ndodhur kryesisht në dëm të hapësirave ekzistuese natyrore/bujqësore. Ekziston një nevojë themelore që në kuadër të PZHK të sigurohet gjetja e ekuilibrit ndërmjet interesave shoqëroro-ekonomike dhe të mjedisit duke tërhequr vëmendjen e posaçme tek masat për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe duke siguruar masa lehtësuese për ndikimet e mundshme negative.

## 7.1 ANALIZA MJEDISORE E SKENARËVE TË PROPOZUAR ALTERNATIVË

Gjatë fazës së krijimit të fushëveprimit (shih 5.2), janë propozuar tre skenarë alternativë për t'u adresuar në raportin aktual VSM. Në këtë kapitull, këta skenarë do të përshkruhen dhe do të analizohen, do të krahasohen dhe do të propozohet alternativa e parapëlqyer.

### 7.1.1 SKENARI I MOS-BËRJET ASGJË

Sipas skenarit të mos-bërjet asgjë i cili do të rezultonte nëse nuk do të zhvilloheshin kurrfarë aktivitetesh zhvillimore të planifikuara në mënyrë strategjike, zona e PZHKP 2025 do t'i mbante karakteristikat e saj aktuale fizike, mjedisore dhe shoqëro-ekonomike. Zhvillimi do të shënohej brenda kufijve dhe parametrave ekzistuese të zhvillimit. Investimi i ardhshëm nga Komuna e Prizrenit dhe të tjerët do të mungonte aty ku nuk parashikohet me plan zhvillimor dhe roli i komunës si ndikim proaktiv në vend do të humbte. Zbatimi i skenarit të mos-bërjet asgjë do të nënkuptonte që Prizreni do të mbetej pak i shfrytëzuar me përmirësim të vogël fizik, shoqëror ose ekonomik. Tendenca urbanistike do të mund të vazhdonte e pakontrolluar me rezultat të mundshëm të shtrirjes urbane e cila është e lidhur me shtrirjen e paplanifikuar të zhvillimit në vendet jashtë dhe brenda qytetit të Prizrenit. Bërthama e qytetit mund të humbë me rritjen e re të paplanifikuar jashtë mase. Ky model i zhvillimit shpesh rezulton me rritje më të madhe se që pritet dhe në një shkallë më të shpejtë se që pritet me vështirësi në lidhje me kërkesat problematike shoqërore, të transportit dhe të infrastrukturës së gypave për ta planifikuar hapin e mundshëm të zhvillimit. Në anën tjetër, gjendja shoqëro-ekonomike dhe mjedisore në viset rurale do të mund të përkeqësohej në mënyrë të konsiderueshme nëse ofrimi i shërbimeve publike dhe i mundësive për punë ulet dhe projektet e propozuara të udhëhequra nga qëndrueshmëria nuk do të zbatohen. Meqë në thelb PZHKP 2025 është menduar për t'i zgjedhur çështjet aktuale mjedisore dhe për ta përkrahur zhvillimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm dhe përfshin vetëm disa propozime për projekte të cilat mund të përfshijnë (nëse nuk planifikohen, përgatiten dhe zbatohen në mënyrë të arsyeshme) disa ndikime negative në mjedis, skenari i mos-bërjet asgjë do të mund të konsiderohej si ai i parapëlqyeri.


### 7.1.2 ZBATIMI I PLOTË I SKENARIT TË PZHKP 2025

Ky skenar do të thotë që do të zbatohet koncepti i zhvillimit hapësinor i qasjes policentrike, në nën-qendra do të sigurohet një nivel shtesë i shërbimeve publike me shpresën e ruajtjes së rritjes dhe të zhvillimit të lagjeve rurale. Një *rajon hierarkik policentrik* përmban disa qendra urbane të cilat janë të organizuara në strukturë hierarkike të vendit kryesor. Në këtë strukturë urbane, një qendër (qyteti i Prizrenit) dominon mbi të tjerat. Kjo qasje aktualisht është shumë e përhapur dhe është në pajtim me Perspektivën Evropiane të Zhvillimit Hapësinor (PEZH)³. Ajo duhet të ndihmojë në gjetjen e baraspeshës ndërmjet viseve rurale dhe urbane dhe të ofrojë kushte që viset rurale t'i asimilojnë ndryshimet strukturore në mënyrë më të suksesshme. Pasi që në Prizren tendenca e rritjes së popullsisë tregon që qyteti i Prizrenit priret të bëhet më i madh dhe të zgjerohet drejt periferive. Nëse nuk menaxhohet si duhet kjo rritje do të përbëjë kërcënim për zonat me vlera të pasura ekologjike ndërmjet qendrës së qytetit dhe vendbanimeve periferike. Për ta zvogëluar atë kërcënim dhe në mënyrë që të ketë për qëllim zhvillimin e ekuilibruar hapësinor PZHKP 2025 propozon Konceptin e Zhvillimit policentrik. Nëse zbatohet si duhet, nuk mund të parashikohet kurrfarë ndikimi domethënës negativ si rezultat i zgjedhjes së konceptit hapësinor. PZHKP po ashtu shfrytëzon mjetin e Procesit Analitik të Hierarkisë (PAH) për t'i treguar zonat e përshtatshme për zhvillim të ardhshëm (siç është banimi, industria, turizmi, bujqësia, etj). Ky mjet mundëson marrjen parasysh të të dhënave të përshtatshme hapësinore në mënyrë që të vlerësohet përshtatshmëria e hapësirës për qëllime specifike. Si rrjedhojë e kësaj janë përgatitur hartat PAH ku mund të gjenden hapësirat e përshtatshme për zhvillimet e ardhshme. Pasi që karakteristikat sipas të cilave shënohet hapësirat e përshtatshme mund të vlerësohen në përgjithësi në mënyrë të përshtatshme, zbatimi i mëtejshëm i rezultatit të analizës duhet të ketë ndikime pozitive mjedisore. Ato sugjerojnë që aktivitetet me mundësi ndotëse (të banimit, industriale, bujqësore) përjashtohen në hapësirat e cënueshme në aspektin e mjedisit. Por PZHKP 2025 nuk i integron rezultatet PAH me qasjen e zhvillimit policentrik për të ofruar strukturë koherente hapësinore/ndarje në zona (vetëm disa elemente të vogla të dukshme nga harta e majit 2012). Si rezultat, do të ishte sfiduese që të zbatohet mënyra e qëndrueshme dhe e bazuar në analizë për zhvillimin e mëtejshëm të planifikimit hapësinor në Prizren. Prandaj, nëse as koncepti i zhvillimit policentrik as rezultatet PAH nuk zbatohen në mënyrë efikase, mund të përfundojë me zhvillimin

<sup>3</sup> [http://ec.europa.eu/regional\\_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/pdf/sum_en.pdf)

e vazhdueshëm të rastësishëm të hapësirave të vendbanimeve/industriale dhe me ndikime negative në mjedis. Do të zhvillohet i gjithë procesi i zbatimit prej të cilit dalin kryesisht ndikimet mjedisore pozitive. Edhe pse, meqë ekziston një shkallë e gjerë e projekteve përgatitore (përgatitja e planeve/programeve kryesisht të caktuara për tremujorin e parë të periudhës së PZHKP 2025) shumë ndikime të mundshme mjedisore (të cilat do të mund të vlerësoheshin po të zbatoheshin tashmë planet e propozuara) mbesin të matura dhe jo të drejtpërdrejta.

Figura 7.1.2. Ilustrimi i konceptit të zhvillimit hapësinor policentrik (ZHKP 2025)



Burimi: Komuna e Prizrenit, PZHKP 2025

### 7.1.3 SKENARI I NDARJES SË INTEGRUAR FUNKSIONALE NË ZONA


Ky skenar përmban elementin kryesor siç është koncepti policentrik hapësinor nga skenari i fundit në mënyrë që ta forcojë dhe ta balancojë raportin urban-rural në atë mënyrë që është e dobishme si për popullsinë urbane ashtu edhe për atë rurale. Por meqë zona e Prizrenit është e ndikuar nga statusi i Kosovës si vend në zhvillim dhe nga tendenca shumë e fuqishme demografike (rritja e popullsisë) ekziston nevoja që të merret parasysh mundësia që presioni i lartë në qytetin e Prizrenit do të vazhdojë dhe do të rritet dhe për këtë arsye elementet e Konceptit Kompakt të Zhvillimit kombinohen me ato policentrike. Theksohet roli i Prizrenit si qendër e fuqishme rajonale me përqendrim të objekteve urbane dhe mundësi të zgjerimit. Për zonat e zgjerimit të qytetit janë shfrytëzuar vetëm vendet e përshtatshme për analizën PAH. Në mënyrë që të ofrojë mundësi të zbatimit të kombinuara më mirë për konceptin e zhvillimit hapësinor (kombinimi i atyre policentrike dhe të kombinuara) së bashku me rezultatet PAH, harta e nevojshme e ndarjes funksionale në zona është përgatitur si bazë për zhvillimet e mëtejshme hapësinore. Ndarja në zona duhet të propozojë vende të përshtatshme për banim, bujqësi, industri, turizëm duke u bazuar në të dhënat PAH, por të gjitha zonat janë të kombinuara në një hartë të ndarjes në zona, ku është eliminuar mbulimi i njëra tjetrës (analiza tregon që sipas analizës PAH rezultojnë që vendet e përshtatshme për banim dhe industri mbulojnë njëra tjetrën shumë) dhe zonat janë të vendosura ashtu që ta mbështesin konceptin e zhvillimit hapësinor. Meqë ky skenar alternativ zvogëlon shumë rrezikun që mund të paraqitet nëse tendenca e urbanizimit vazhdon gjallërisht dhe ofron mbështetje shtesë për zbatim (ndarja e kombinuar funksionale në zona si udhërrëfyes hapësinor për zhvillim të mëtejshëm), në këtë mënyrë identifikohet si skenar i parapëlqyer.

Skenari i tretë po ashtu mbështet qasjen reale si bazë të planifikimit të zonave të reja të banimit. Në PZHKP janë shfrytëzuar disa modele të parashikimit të popullsisë për ta vlerësuar popullsinë e Prizrenit më 2025, vetëm në bazë të qasjes më optimiste popullsia do të mund të rritej deri në gjysmë milioni banorë. Duke e shfrytëzuar dendësinë e shkallës së sugjeruar të popullsisë 175 persona për hektarë nga analiza e kapacitetit të PZHKP, mund të arrihet në përfundim që në të gjitha vendet e përshtatshme të identifikuar nga PAH (25 000 ha) do të mund të vendoseshin deri

në 4,3 milionë banorë. Edhe nëse ky vlerësim do të zvogëlohej në mënyrë që t'i përfshijë burimet e nevojshme të tokës për infrastrukturë dhe hapësira publike është e qartë që nuk ka mundësi që të gjitha hapësirat e identifikuara të përshtatshme për banim të zhvillohen për vendbanime. Figura më poshtë ilustron qasjen ku rezultatet e analizës PAH për banim dhe industri shfrytëzohen për gjetjen e zonave të caktuara për të dy qëllimet për ta mbështetur zhvillimin e qytetit të Prizrenit si edhe të qendrave të mëdha rajonale. Zonat e zgjerimit për banim të PZHKP do të mund të shërbenin si hapësira të mëtejshme kufitare për dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit të ulët. Harta ilustruese tregon 3000 ha të hapësirave të reja për banim në të cilat do të mund të strehoheshin deri në 500 000 banorë (175 p/ha). Kjo qasje do ta parandalonte vendndodhjen pavend të hapësirave të zhvillimit ose shumë rrallë me hapësirat e përshtatshme, ajo ndihmon planifikimin dhe vendosjen e infrastrukturës, të objekteve të shërbimeve dhe të atyre publike të domosdoshme.

Sipas asaj, skenari i tretë sugjerohet të jetë më i përshtatshmi dhe sugjerohet që harta funksionale e ndarjes në zona (e cila mbështetë përmbajtjen aktuale dhe sugjerimet kryesore të PZHKP 2025) t'i bashkëngjitet planit zhvillimor komunal dhe zhvillimet e mëtejshme dhe planet zhvillimore do të përgatiten dhe të zbatohen në përputhje me rrethanat.

Figura 7.1.3.1 Ilustrimi i skenarit të tretë. Ngjyra kafe e mbyllur tregon hapësirat aktuale të banimit, ngjyra e kafe e hapur tregon hapësirat e mundshme të banimit dhe e hirta tregon hapësirat e mundshme industriale (bazuar në analizën PAH).



Burimi: MuSPP2 SEA Prizren, K.Tilleman

## 7.2 NDIKIMET MJEDISORE TË STRATEGJIVE DHE TË VEPRIMEVE TË ZBATIMIT TË PROPOZUARA

Kapitulli për zbatimin i PZHKB realizohet në atë mënyrë që për ta arritur vizioni e PZHKB 2025 përcaktohen qëllimet strategjike për zhvillimin afatgjatë dhe objektivat e lidhura me të. Pastaj, planet e veprimit zhvillohen duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat dhe projektet përkufizohen me afatin kohor. Kapitulli kryesor i zbatimit nuk përfshin as përkufizimin e organeve përgjegjëse (administrative) për projektet e propozuara as ndonjë indikacion të mjeteve të nevojshme financiare. Edhe pse perspektiva kohore e PZHKB 2025 është caktuar të jetë 15 vjet, shumica e projekteve të propozuara parashikohet të zbatohen brenda 2 -5 vjetësh (vetëm faza e një projekti është caktuar të jetë 15 vjet), duke e pasur parasysh fushëveprimin dhe ambicien e projekteve nuk ka mundësi që të gjitha projektet e propozuara të zbatohen gjatë afatit kohor të propozuar. Për veprimet e zbatimit nuk janë propozuar indikatorë dhe qëllime dhe në anën tjetër kjo do ta komplikojë monitorimin e përparimit të zbatimit të planit. Në mënyrë që të ruhet arritja e ndikimeve të mundshme pozitive në mjedis të zbatimit të PZHKB 2025, me anë të kësaj propozohet që të korrigohet perspektiva e propozuar e fazave të projekteve, për t'i shtuar organet përgjegjëse (administrative) dhe indikatorët financiarë. Është me rëndësi të theksohet që pothuajse të gjitha projektet propozohen për tre muajt e parë të periudhës së PZHKB 2025 dhe shumë prej tyre nuk janë projekte të zbatimit por plane/programe për përgatitjen e aktiviteteve të caktuara. Prandaj, gjatë procesit monitorues të planit do të ishte thelbësore, sipas nevojave dhe mjeteve të korrigjuara, që të shtohen projektet e zbatimit që do të kryhen gjatë fazës së mëvonshme të periudhës së planit.

Në vazhdim, vlerësohen ndikimet e mundshme mjedisore të projekteve të propozuara, strukturohen sipas vendosjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike. Një ndikim do të vlerësohet si domethënës nëse ka mundësi që ta tejkalojë kufirin e përballimit të hapësirës, të shkaktojë ndryshime të pakthyeshme në mjedis ose ta kërcënojë shëndetin dhe mirëqenien njerëzore, trashëgiminë ose pasurinë kulturore.

Parimi i parë i PZHKB 2025 (A) i "Ruajtjes së Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore" përfshin 2 qëllime kryesore strategjike, si *trashëgimia kulturore do të ruhet dhe përmirësohet* (1) dhe *trashëgimia natyrore do të ruhet dhe përmirësohet* (2). Në kuadër të qëllimit të parë janë propozuar 7 projekte, meqë asnjëri prej tyre nuk përfshin ndonjë strukturë të vërtetë ose aktivitete të tjera dhe ato parashohin vetëm përbërjen e programeve, projekteve dhe planeve të ndryshme, ato nuk përfshijnë ndonjë ndikim të rëndësishëm mjedisor. Nëse këto plane, projekte dhe programe do të zhvillohen dhe/ose zbatohen, duhet të diskutohet domosdoshmëria e VSM/VNM për t'i vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore

Tabela 7.1.3.1 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi *trashëgimia kulturore do të ruhet dhe përmirësohet*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
A.1.1.1	Programet për zbatimin e planeve urbane dhe projektet për qendrën historike të qytetit të Prizrenit	Neutral	-	-	-	-
A.1.2.1	Projektet gjithëpërfshirëse të restaurimit për ndërtesat historike	Neutral	-	-	-	-
A.1.3.1	Projektet e rehabilitimit të ndërtesave dhe objekteve historike për strehim dhe shërbime kulturore –turistike	Neutral	-	-	-	-
A.1.3.2	Projektet e restaurimit për ndërtesat monumentale	Neutral	-	-	-	-
A.1.3.3	Plani për menaxhimin e vendeve historike	Neutral	-	-	-	-
A.1.3.4	Programi përkrahës 'Vizitoni Prizrenin'	Neutral	-	-	-	Shoqëroro-Ekonomik+
A.1.4.1	Programi arsimor 'Mbrojeni Prizrenin'	Neutral	-	-	-	-

Qëllimi i dytë strategjik Trashëgimia Natyrore do të ruhet dhe përmirësohet përfshin katër propozime të projekteve. Tri prej këtyre propozimeve përfshijnë përgatitjen e projekteve dhe një prej tyre projektet VNM, prandaj vlerësohet se paraqitet vetëm ndikimi i dobët/i moderuar meqë ndikimet e vërteta varen nga përmbajtja e projekteve dhe efikasitetit i zbatimit të tyre.

Tabela 7.1.3.2 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi *trashëgimia natyrore do të ruhet dhe të përmirësohet*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia NM	Afati kohor NM	Fushëveprimi Gjeografik NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
A.2.1.1	Projekti i Menaxhimit për Trashëgiminë Natyrore	Pozitiv	E dobët	Afatshkurtër	Lokal	-
A.2.2.1	Projekti i Integruar me Përcaktim Turizmin Natyror dhe Historik	Pozitiv	E dobët	Afatshkurtër	Nacional	-
A.2.3.1	Projekti për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor për Parkun Nacional Malet e Sharrit	Pozitiv	E moderuar	Afatshkurtër	Nacional	-
A.2.4.1	Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve për Zhvillimin e Turizmit	Neutral	-	-	-	-

Sipas parimit të dytë (B) të PZHKP 2025 qëllimi kryesor strategjik është *do të sigurohet mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve mjedisore*. Për ta arritur këtë qëllim janë propozuar 10 ide për projekte, nëntë prej tyre janë plane, projekte dhe programe dhe një projekt për zbatim është për ndërtimin e objekteve për trajtim. Edhe pse zbatimi i mundshëm i projekteve të propozuara përfshin ndikime mjedisore pozitive mjaft të fuqishme, ndikimi i përgatitjes së projekteve si i tillë nuk përfshin ndikime të fuqishme

Tabela 7.1.3.3 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi *do të sigurohet mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve*

Kodi	Emri i projektit name	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
B.1.1.1	Plani Zhvillimor për Turizmin Natyror	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Ndërkombëtar	-
B.1.1.2	Plani i Menaxhimit të Shtratit të Lumit	Pozitiv	E fuqishëm	Afatgjatë	Ndërkombëtar	-
B.1.1.3	Ndërtimi i Objekteve për Trajtim	Pozitiv	Shumë e fuqishme	Afatgjatë	Ndërkombëtar	-
B.1.2.1	Projekti për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor	Pozitiv	E moderuar	Afatshkurtër	Nacional	-
B.1.2.2	Projektet e Posaçme për Mbrojtjen e Lumenjve për Projektet Lumenjtë Lumbardhë dhe Drini i Bardhë	Pozitiv	E moderuar	Afatmesëm	Nacional	-
B.1.3.1	Projekti për Vlerësimin e Rrezikut për Zonat Natyrore	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	-
B.1.4.1	Plani për Menaxhimin e Pyjeve	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	-
B.1.4.2	Projekti Hetues për Zbulimin e Aktiviteteve të Gurëthyesve	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	-
B.1.4.3	Projekti Rehabilitues për Zonat e Paligjshme për Gurëthyes	Pozitiv	E fuqishëm	Afatgjatë	Lokal/Nacional	-
B.1.5.1	Programet Arsimore Bujqësore	Pozitiv	E dobët	Afatmesëm	Lokal	-

Parimi i tretë (C) i PZHKP 2025 “Përfshirja sociale, barazia sociale dhe cilësia e jetesës” përfshin tri qëllime kryesore strategjike si do të sigurohen objektet publike të balancuara dhe me mundësi shfrytëzimi (1), do të sigurohen mundësitë e reja për punësim dhe shkalla e papunësisë do të ulet (2) dhe do të inkurajohet pjesëmarrja publike në vendimmarrje (3)

Duke e pasur parasysh natyrën dhe karakteristikat e projekteve si edhe supozimin, vendet për ndërtim (kopshtet e fëmijëve, shkollat fillore, shkollat e mesme, objektet kulturore, objektet sportive) do të zgjidhen duke e pasur parasysh që shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të tokës dhe aktivitetet e ndërtimit do të zhvillohen sipas parimeve të ndërtimit të qëndrueshëm, shumica dërrmuese e projekteve të propozuara për atë parim nuk duhet të përfshijnë ndonjë ndikim domethënës dhe të drejtpërdrejtë mjedisor. Sidoqoftë, ndikimet e tërthorta mund të ndodhin nëse gjendja shoqëro-ekonomike përmirësohet konsiderueshëm nga ofrimi i shërbimeve publike shtesë dhe rënia e shkallës së papunësisë.

Tabela 7.1.3.4 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, parimi *Përfshirja sociale, barazia sociale dhe cilësia e jetesës*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
C111	Rikualifikimi dhe Projekti Vlerësues Organizativ i Objekteve Urbane	Neutral	-	-	-	-
C121	Projektet për Ndërtimin e Kopshteve për Fëmijë për Secilin Fshat	Neutral	-	-	-	Financiar-, Social+
C122	Projektet për Ndërtimin e Shkollës Fillore për Secilin Fshat	Neutral	-	-	-	Financiar-, Social+
C131	Projekti për Ndërtimin e Shkollës së Mesme	Neutral	-	-	-	Financiar-, Social+
C132	Projekti për Ndërtimin e një Objekti Kulturor për Qëllime të Ndryshme	Neutral	-	-	-	Financiar-, Social+
C133	Projekti për Ndërtimin e Objekteve Sportive në Secilin prej Fshatrave Kryesore	Neutral	-	-	-	Financiar-, Social+
C141	Projekti për Zhvillimin e Kapaciteteve dhe të Cilësisë për Objektet Urbane	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	-
C211	Programi Arsimor për Ndërmarrësinë e të Rinjve	Neutral	-	-	-	-
C212	Krijimi i Agjencisë për Zhvillimin e Projektit dhe Këshillime	Neutral	-	-	-	-
C213	Programi Lokal për Zhvillimin Ekonomik	Neutral	-	-	-	-
C221	Programi për Pranimin në Punë për Shërbimet e Asistencës për Ndërmarrësi Afariste	Neutral	-	-	-	-
C231	Programi për Asistencë të Ndërmarrësisë Bujqësore	Neutral	-	-	-	-
C232	Projekti për Planifikim të Komunitetit (PPK)	Pozitiv	E dobët	Afatmesëm	Lokal	-
C311	Projekti e-Prizreni	Pozitiv	E dobët	Afatgjatë	Lokal	Inovativ+
C321	Projekti i e-buletinit komunal	Neutral	-	-	-	-

Parimi i katërt (D) i PZHKP 2025 “Vitaliteti ekonomik” përfshin pesë qëllime strategjike. Ato janë:

1. Do të sigurohet zhvillimi i menaxhuar dhe i balancuar rural
2. Do të mbështetet prodhimi bujqësor
3. Do të përkrahen dhe do të organizohen aktivitetet prodhuese
4. Do të përkrahen aktivitetet tregtare dhe financiare
5. Aktivitetet e turizimit në Prizren do të zhvillohen dhe do të përmirësohen

Meqë projektet e propozuara nuk përfshijnë përshkrim specifik të aktiviteteve të planifikuara, ndikimet e supozuara parashikohen dhe vlerësohen. Janë gjithsej 16 projekte të propozuara për qëllimet e sipërpërmendura strategjike, disa prej tyre janë programe ose plane përkrahëse/këshilluese të cilat nuk përfshijnë ndonjë ndikim të rëndësishëm ose negativ në mjedis. Sipas parimeve aktuale, disa prej projekteve mund të përfshijnë ndikime negative mjedisore nëse nuk zbatohen plotësisht në mënyrë të qëndrueshme.

Tabela 7.1.3.5 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, parimi *Vitaliteti ekonomik*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
D111	Programi për Shërbim të Asistencës Ndërmarrësisë Biznesore	Neutral	-	-	-	-
D211	Programet e Trajnimit dhe të Këshillimit për Prodhimin e Kafshëve	Neutral	-	-	-	
D212	Fondet Komunale Stimuluese për Prodhimin e Kafshëve	Negativ	E moderuar	Afatmesëm	Lokal	Ekonomik +
D213	Programi ‘Prodhuar në Prizren’	Neutral	-	-	-	-
D214	Programet e Trajnimit dhe të Këshillimit për Prodhimet e Qumështit	Neutral	-	-	-	-
D2aa	Projekti për Zhvillimin Bujqësor	Negativ	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	Ekonomik +
D311	Projekti për Zonën e Re të Industrisë Bujqësore	Negativ	E moderuar	Afatmesëm	Lokal	Ekonomik +
D321	Programi Arsimit për Prodhimin e Pijeve Lokale	Neutral	-	-	-	-
D322	Programi Arsimit për Prodhimin e Filigranit	Neutral	-	-	-	-
D411	Programi i Vazhdueshëm Arsimit për Aktivitete të Shitjes me Pakicë dhe Tregtare	Neutral	-	-	-	Ekonomik +
D421	Projekti i Njës Logjistike	Negativ	E dobët	Afatgjatë	Lokal	Ekonomik +
D511	Krijimi i një Zyreje për Turizëm në Qytetin Prizrenit	Neutral	-	-	-	-
D521	Standardizimi dhe Programi i Kontrollit për Objektet e Turizmit	Neutral	-	-	-	-
D531	Projekti i Qendrës së Skijimit në Prevallë	Negativ	E fuqishme	Afatgjatë	Nacional	Ekonomik +
D532	Projekti i Agro-Turizmit në Fushën e Podrimës	Neutral	-	-	-	Ekonomik +
D533	Menaxhimi i Turizmit dhe Plani Zbatues për Parkun Nacional Malet e Sharrit	Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Ndërkombëtar	Ekonomik+

Parimi i fundit, i pesti (E) “Integriteti hapësinor” përfshin dy qëllime strategjike: *do të krijohen mjedise tërheqëse për jetesë* (1) dhe *do të sigurohet transporti dhe rrjeti infrastrukturor efektiv dhe i integruar në hapësirë* (2). Qëllimi i parë përfshin tri ide për projekte dhe i dyti shtatë të tilla, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë të orientuara drejt përmirësimit të mjedisit natyror/të jetesës dhe kanë ndikime mjaft pozitive në mjedis. Megjithatë, disa prej projekteve të infrastrukturës (rrugët e reja të transportit/zgjedhja e vendeve të energjisë së erës) mund të përfshijnë ndikime negative të cilat duhet të vlerësohen ende gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve të propozuara.

Tabela 7.1.3.6 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi *do të krijohen mjedise tërheqëse për jetesë*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
E111	Korrigjimi i Planit të Zhvillimit Urban të Projektit të Qytetit të Prizrenit në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit	Pozitiv	E moderuar	Afatmesëm	Lokal	-
E112	Planet Rregulluese Urbane për Secilin prej Fshatrave Kryesore	Pozitiv	Shumë e fuqishme	Afatgjatë	Lokal	-
E1aa	Planifikimi dhe Projektimi i Qëndrueshëm i Banimit, Udhërrëfyese për Projektimin Urban të Prizrenit	Pozitiv	E fuqishme	Afatgjatë	Lokal	-

Tabela 7.1.3.7 Matrica e ndikimit mjedisor të projekteve, qëllimi *do të sigurohet transporti dhe rrjeti infrastrukturor efektiv dhe i integruar në hapësirë.*

Kodi	Emri i projektit	Ndikimi Mjedisor (NM)	Fuqia e NM	Afati kohor i NM	Fushëveprimi Gjeografik i NM	Ndikimet e tjera të rëndësishme
E2aa	Masterplani për Transport	Negativ	E moderuar	Afatgjatë	Lokal	Ekonomik+
E241	Projektimi i Komunikacionit dhe Plani i Menaxhimit për Qytetin e Prizrenit	Neutral	-	-	-	-
E251	Projekti i Renovimit të Sistemit Elektrik	Neutral	-	-	-	Financiar-Ekonomik+
E252	Potenciali i Energjisë së Erës dhe Projekti për Zgjedhjen e Vendit	Negativ/Pozitiv	E moderuar	Afatgjatë	Nacional	Ekonomik+
E253	Projekti për Renovimin dhe Krijimin e Rrjetit të Komunikimit	Neutral	-	-	-	Shoqëroro-ekonomik+, Financiar-
E254	Projekti për Renovimin e Sistemit të Kanalizimit dhe të Projektit të Ndërtimit të Njësive të Pastrimit në Vendet e Hedhjes	Pozitiv	Shumë e fuqishme	Afatgjatë	Ndërkombëtar	Financiar-
E255	Projekti për Renovimin dhe Krijimin e Sistemit të Ujitjes	Negativ/Pozitiv	E fuqishme	Afatgjatë	Lokal	

### 7.3 MASAT LEHTËSUESE

Objektivi dhe qëllimi i masave lehtësuese është shmangia ose ulja e ndikimit të mundshëm negativ në mjedis. Zgjedhja e masave më të përshtatshme lehtësuese është një proces i vazhdueshëm gjatë tërë periudhës së zhvillimit dhe duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë të të gjithë aktorëve relevantë (vendimmarrësit, ekspertët, investitorët, banorët lokalë, OJQ-të). Masa e përshtatshme lehtësuese duhet të jetë më e mira në mesin e alternativave të mundshme dhe duhet t'i marrë parasysh edhe aspektet ekonomike.

Edhe pse gjatë fazës së vlerësimit nuk janë identifikuar ndikimet më të mëdha negative, ende ekziston nevoja për shmangien ose zvogëlimin e efekteve të mundshme negative që mund t'i kenë disa prej aktiviteteve të PZHK:

- gjatë planifikimit dhe krijimit të zonave të reja industriale, atraksioneve turistike, vendbanimeve ose infrastrukturës ekziston nevoja për gjetjen e një baraspeshe ndërmjet interesave shoqëroro-ekonomikë dhe atyre mjedisorë duke planifikuar korridore të gjelbra, tampon zona, përkrahje dhe zbatim të zgjidhjeve të qëndrueshme energjetike, etj. gjatë aktiviteteve zhvillimore duhet të ruhet maksimumi i hapësirave të gjelbëruara ekzistuese;
- menaxhimi i burimeve pyjore ekzistuese duhet të jetë në veçanti i qëndrueshëm në mënyrë që të sigurohet ruajtja e biodiversitetit pyjor dhe përfitimet ekonomike afatgjata të menaxhimit të qëndrueshëm pyjor;
- gjatë planifikimit dhe krijimit të objekteve turistike në zonat e vlefshme natyrore, sidomos në Parkun Nacional Malet e Sharrit, aktivitetet e përshtatshme duhet të zgjidhen sipas kapaciteteve të zonës; lëvizja e vizitorëve duhet të organizohet si duhet (me shtigje për ecje, vende për parkim, tualete, vende për pushim) në mënyrë që të rritet shfrytëzimi i peizazheve dhe hapësirave të vlefshme natyrore nga planet e propozuara të menaxhimit, ekziston nevoja jetike për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe të organeve përgjegjëse të menaxhimit të Parkut Nacional në mënyrë që të parandalohet planifikimi dhe zhvillimi i gabuar i projektit brenda kufijve të parkut;
- gjatë planifikimit dhe krijimit të zonave industriale ekziston nevoja që të rezervohet hapësira e zonave sanitare dhe e tampon zonave dhe që objektet e papërshtatshme industriale (niveli i madh i zhurmës, ndërtesat masive, transporti i madh) të mos vendosen në afërsi të vendbanimeve dhe të vendeve me vlerë të madhe natyrore/piktorese.

## VIII. PËRFUNDIM

Procesi i vlerësimit strategjik mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit përfshin një varg të gjerë të fushëveprimeve nga ato globale (Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit) deri te ato lokale (shkollat e reja në vendbanimet rurale). Edhe pse planifikohet dhe zbatohet në nivel lokal PZHKP 2025 do ta ketë pjesën e vetë në dhënien e kontributit në përpjekjet e të Kosovës, të Evropës dhe të botës për t'u marrë me grupin kompleks të sfidave siç është ndryshimi i klimës, humbja e biodiversitetit, ndotja, urbanizimi, etj. Autoritetet e Komunës së Prizrenit së bashku me hartuesit e planit dhe aktorët e përfshirë janë përballur me këtë sfidë në mënyrë të suksesshme dhe dokumenti i përgatitur i planifikimit krijon bazë të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të qëndrueshëm që korrespondon mirë me planet dhe programet e nivelit të lartë. Njëra prej pasurive dhe përparësive të këtij dokumenti shumë gjithëpërfshirës është mbledhja edhe analizimi i të dhënave aktuale dhe gjendjes së komunës. Përveç PZHK aktual, këto të dhëna të paraqitura si kapituj, tabela dhe harta përshkruese do të jenë tepër të dobishme për aktivitetet tjera planifikuese në Prizren po ashtu. Pjesët strategjike, hapësinore dhe zbatuese të dokumentit planifikues bazohen në të dhënat e mbledhura dhe në analizimin e përshtatshëm. Çështja e qëndrueshmërisë është përfshirë si politikë me prioritet në strategjinë e zonës – objektivat, dispozitat zbatuese që rrjedhin në përputhje me rrethanat. Meqë në përgjithësi PZHKP është i orientuar drejt përmirësimit të gjendjes aktuale, asaj ekonomike si edhe mjedisore, zbatimi i këtij plani nuk do të kishte ndonjë ndikim domethënës negativ në mjedis. Ai adreson kryesisht dhe në mënyrë adekuate sfidat kryesore të mjedisit me të cilat përballet Prizreni, si: cilësia e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, çështja e mbeturinave të ngurta, trajtimi i ujërave të zeza dhe modelet e shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës. Në mënyrë që PZHKP 2025 të zbatohet në mënyrë efektive në pajtim me parimet e qëndrueshmërisë, ky raport VSM propozon një grup të objektivave, indikatorëve dhe qëllimeve mjedisore, të cilat rrjedhin nga PZHK dhe janë në pajtim me parimet e zhvillimit modern të qëndrueshëm dhe me planet dhe programet e nivelit të lartë. Këto objektiva duhet të zbatohen dhe monitorohen paralelisht me PZHK aktual. Nga tre skenarët e propozuar alternativë për mjedisin (të mos-bërit asgjë, zbatimi i plotë dhe skenarët e kombinuar) është propozuar skenari i kombinuar. Sipas asaj alternative PZHK aktual do të plotësohet me kornizë hapësinore më specifike e cila bazohet në rezultatet e analizës PAH dhe kombinon elementet e koncepteve policentrike dhe të përqendruara të zhvillimit hapësinor. Ai propozon që me PZHK do të përcaktohet numri i përshtatshëm i hapësirave zhvillimore të vendosura në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që të lehtësohen proceset e mëtejshme vendimmarrëse duke ofruar perspektiva të qarta zhvillimore për të ardhmen dhe udhëzime hapësinore për dokumentet e planifikimit të nivelit të ulët. Ai po ashtu parandalon vendosjen e papërshtatshme dhe tepër rrallë të zhvillimeve (me ndikime të mundshme negative në mjedis) dhe ndihmon në planifikimin dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme, si edhe të shërbimeve publike dhe private. Në raportin VSM përfshihet vlerësimi mjedisor i planit, qëllimet e tij strategjike, objektivat dhe projektet zbatuese. Si rezultat i këtij vlerësimi nuk janë identifikuar kurrfarë ndikime të ardhme mjedisore. Megjithatë, projektet e propozuara të zbatimit kanë qenë goxha të përgjithshme sipas natyrës (kryesisht hartim i planeve dhe i programeve) dhe kanë mbuluar vetëm periudhën pesë vjeçare të PZHKP 2025. Prandaj propozohet që ose para aprovimit përfundimtar të PZHK ose gjatë korrigjimit të planit, lista e projekteve të korrigjohet me organet përgjegjëse dhe të ndryshohet me projektet afatmesme dhe afatgjata në mënyrë që të arrihen qëllimet strategjike të planit. Përfshirja e hapave të qartë do t'i mbrojë si objektivat ekonomike po ashtu edhe ato mjedisore të planit.

## IX. MONITORIMI

Si pjesë e procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në Raportin VSM duhet të përfshihen masat e parashikuara për monitorimin e efekteve të mundshme të rëndësishme të zbatimit të PZHKP 2025. Qëllimi kryesor i monitorimit të rregullt është identifikimi i efekteve të mundshme negative të zbatimit të PZHK sa më herët që të jetë e mundur dhe të përfshihen mjetet e nevojshme për parandalimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative.

Qëllimi i sugjerimeve të monitorimit është të ofrojë mbështetje për autoritetin përgjegjës (Komuna e Prizrenit) që t'i vlerësojë ndryshimet në mjedisin natyror gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Prizrenit. Gjatë monitorimit, duhet të ketë mundësi të zbulohet nëse qëllimet strategjike, dispozitat e zbatimit, etj. të planit kanë shkaktuar rezultatet ose përmirësimet e pritura.

Një element thelbësor i monitorimit VSM është që herë pas here të vëzhgohet përparimi i arritjes së objektivave mjedisore, përbushja e qëllimeve të caktuara. Një listë e indikatorëve dhe qëllimeve mjedisore është ofruar në Tabelën 2. Ato kanë rrjedhë nga njohuria për çështjet ekzistuese mjedisore në zonën e Prizrenit dhe po ashtu nga legjislati, udhëzimet dhe dokumentet e tjera relevante. Propozohet që monitorimi të bëhet çdo vit në pajtim me procesin monitorues të vetë PZHKP 2025. Gjatë përgatitjes së raportit aktual VSM të dhënat sasiore mjedisore (cilësia e ujit, ajrit, dheut, etj.) ishin të kufizuara në përgjithësi për Kosovën dhe për zonën e Prizrenit po ashtu. Prandaj propozohet që gjatë procesit të rregullt monitorues të bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së indikatorëve/objektivave të propozuara dhe korrigjimi i tyre nëse ka nevojë dhe/ose mundësi. Nëse bëhet kjo, që rezultatet e monitorimit ta tregojnë përbushjen e ndonjërit nga qëllimet, duhet të diskutohet nëse ekziston nevoja dhe është e domosdoshme që të ngrihet qëllimi. Përderisa nuk krijohen sistemet monitoruese për mbledhjen e të dhënave të domosdoshme mjedisore (ndotja e ujit, etj.), monitorimi i disa objektivave mjedisore duhet të bëhet në bazë të vlerësimit, duke e vlerësuar shkallën e ndikimit të projektit të caktuar (d.m.th. ndërtimi i objektit për trajtimin e ujërave të zeza) në mjedis (cilësia e ujit).

Përveç monitorimit të objektivave dhe qëllimeve specifike mjedisore duke i matur indikatorët, duhet të shqyrtohen aspektet mjedisore ndërsa vlerësohet progresi i zbatimit të vetë planit. Kjo mundëson identifikimin e ndikimeve të vërteta mjedisore të projekteve të zbatuar dhe propozimin e masave të tjera lehtësuese si sugjerime për korrigjimin e planit nëse është e nevojshme. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet zbatimit të projekteve nëse matrica në kapitullin 6.3 ka treguar që projekti ka ndikim mjedisor ose pozitiv ose negativ. Në të dy rastet duhet të matet dhe të vlerësohet shkalla e ndikimit të projektit ose e aktivitetit të zbatuar. Në rast se në plan shtohen projekte ose aktivitete të reja gjatë monitorimit të tij, ndikimet e ardhshme në mjedis dhe ndikimet e tjera duhet të vlerësohen duke e ndjekur shembullin e matricës së ofruar në këtë raport.

## X. REFERENCAT

### Literatura:

- Renewable & Appropriate Energy Laboratory Energy & Resources Group , University of California, (2012). *Sustainable Energy Options for Kosovo. An analysis of resource availability and cost* . Berkeley, 2012  
[WWW document] URL: <http://coolclimate.berkeley.edu/sites/all/files/Kosovo20May2012.pdf>
- European Commission (2010). *Communication from the Commission EUROPE 2020. A strategy for smart, sustainable and inclusive growth*. COM(2010) 2020 final. Brussels.  
[WWW document] URL: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>
- Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). *Strategic environmental assessment: a sourcebook and reference guide to international experience*. Earthscan, USA
- Marsden, S. (2008). *Strategic Environmental Assessment in International and European Law*. Earthscan, USA
- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). *Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020*. Prishtinë, 2011
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit (2011). *Strategjia dhe Plani i Veprimt për Biodiversitet 2011 – 2020*. Prishtinë.
- Nushi, L. (2011). *Përmirësimet për Sistemin e Planifikimit Hapësinor të Kosovës. Projekti Capstone*. Tema e masterit, AUK & RIT. [dokumenti WWW] URL: [https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi\\_CapstoneProject\\_Report\\_5-06-2011.pdf?sequence=6](https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13686/LuanNushi_CapstoneProject_Report_5-06-2011.pdf?sequence=6)
- School of Business, Economics and Law. University of Gothenburg. Department of Economics Environmental Economics Unit. (2008). *Kosovo Environment and Climate Analysis*. [WWW document] URL: <http://www.sida.se/Global/Countries%20and%20regions/Europe%20incl.%20Central%20Asia/Kosovo/Environmental%20policy%20brief%20Kosovo.pdf>
- The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). *Strategic Environmental Analysis of Kosovo*. REC field office in Kosovo, Pristina. [WWW document] URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
- Therivel, R.; Wilson, E.; Thompson, S.; Heaney, D. and D. Pritchard (1992) . *Strategic Environmental Assessment*. London, Earthscan.
- Tofaj, F., Gashi, L., Jaha, T., Toska, E., Bakija, D.(2010). *A është Juniku unik? Krijimi i dokumenteve për politikat e planifikimit “brenda”* REAL CORP 2010 Proceedings/Tagungsband. [dokumenti WWW] URL: [http://www.corp.at/archive/CORP2010\\_87.pdf](http://www.corp.at/archive/CORP2010_87.pdf)
- United Nations Economic Commission for Europe. (2008) Spatial Planning. Key Instrument for Development and Effective Governance. [WWW document] URL: [http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial\\_planning.e.pdf](http://www.unece.org/fileadmin/DAM/hlm/documents/Publications/spatial_planning.e.pdf)
- United Nations General Assembly (2000). *United Nations Millennium Declaration*  
[WWW document] URL: <http://www.un.org/millennium/declaration/ares552e.pdf>

World Bank (2012). *Kosovo Country Environmental Analysis. Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review and Public Environmental Expenditure Review*.

[WWW document] URL: <http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA.pdf>

Legal Acts:

European Parliament/Council SEA Directive, 2001. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT>

European Parliament/Council Habitats Directive, 1992. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992L0043:EN:NOT>

European Parliament/Council Water Framework Directive, 2000. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0060:EN:NOT>

The UNECE Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters (Aarhus Convention), 1998. [WWW document] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Espoo Convention), 1991. [WWW document] URL: [http://www.unece.org/env/eia/about/eia\\_text.html](http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html)

UNECE Protocol on Strategic Environmental Assessment to the Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (Kiev Protocol), 2003. [WWW document] URL: [http://www.unece.org/env/eia/about/sea\\_text.html](http://www.unece.org/env/eia/about/sea_text.html)

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor. [dokumenti WWW] URL: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003\\_14\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf)

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit. [dokumenti WWW] URL: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>

